



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I HISTORISË**



Autoreferat i disertacionit me temë:

**POLITIKA ADRIATIKO-BALLKANIKE E AHMET ZOGUT NË VITET 1925-1928**

Në kërkim të gradës shkencore “DOKTOR”

**Specialiteti: HISTORI**

Kandidati:  
Elona KAZAZI

Udhëheqësi shkencor:  
Prof. Dr. Beqir META

Tiranë, 2021

## **PËRMBAJTJA E STRUKTURËS SË DISERTACIONIT**

Lista e shkurtimeve

Tabelat dhe figurat

*Parathënia*

Hyrja

### **KREU I**

#### **PRESIONI ITALIAN DHE ORIENTIMI POLITIK I SHQIPËRISË DREJT ITALISË NË VITET 1926-1928**

I.1. Republika Shqiptare, funksionet dhe organizimi i brendshëm i saj

I.2. Pakti i I i Tiranës (Pakti i Miqësisë dhe Sigurimit)

I.3. Pakti i II i Tiranës (Traktati i Aleancës Mbrojtëse)

### **KREU II**

#### **ORIENTIMI I EKONOMISË SË SHQIPËRISË DREJT ITALISË NË VITET 1925-1926**

II.1. Krijimi i Bankës Kombëtare dhe veprimtaria e saj

II.2. Zbatimi i huasë SVEA

II.3. Përplasja anglo-italiane për koncesionin e vajgurit

II.4. Shoqëria AIPA dhe nafta shqiptare

### **KREU III**

#### **MARRËDHËNIET POLITIKE DHE EKONOMIKE TË REPUBLIKËS SHQIPTARE ME JUGOSLLAVINË NË VITET 1925-1928**

III.1. Çështja e Shën Naumit

III.2. Përpyjekjet e Jugosllavisë për koncesione ekonomike në Shqipëri

III.3. Ndikimi i Jugosllavisë në kryengritjen e Dukagjinit

III.4. Vrasja e Ceno bej Kryeziut

### **KREU IV**

#### **MARRËDHËNIET E SHQIPËRISË ME GREQINË NË VITET 1925-1928**

IV.1. Çështja çame

IV.2. Marrëveshjet midis Shqipërisë dhe Greqisë

### **KREU V**

#### **MARRËDHËNIET E SHQIPËRISË ME TURQINË, RUMANINË DHE BULLGARINË NË VITET 1925-1928**

V.1. Marrëdhëniet e Shqipërisë me Turqinë

V.2. Marrëdhëniet e Shqipërisë me Rumaninë

V.3. Marrëdhëniet e Shqipërisë me Bullgarinë

**Përfundime**

**Bibliografia**

## **I - OBJEKTI I STUDIMIT**

Objekt i studimit me temë “Politika adriatiko-ballkanike e Ahmet Zogut në vitet 1925-1928” është politika e jashtme e shtetit shqiptar në këtë periudhë, duke u përqëndruar tek balanca e mbajtur në politikëbërjen kundrejt Italisë dhe Jugosllavisë. Përderisa për mbrojtjen e të drejtave të tyre shqiptarët nuk kishin përkrahjen e faktorit ndërkombëtar, mbijetesa e shtetit shqiptar mund të sigurohej vetëm përmes kësaj balance. Studimi flet për një periudhë të shkurtër kohore, por dhe shumë delikate, si pasojë e problemeve dhe vështirësive të shumta që haseshin si në politikën e brendshme, ashtu edhe në atë të jashtme. Në të trajtohet nevoja e qeverisë shqiptare për t’u orientuar drejt Italisë dhe Jugosllavisë dhe gjithashtu interesi i politikës italiane dhe i asaj jugosllave për çështjen shqiptare, parë në ndërthurje me tërësinë e ngjarjeve në arenën ndërkombëtare. Rëndësi i është kushtuar dhe analizimit të ngjarjeve ndërkombëtare që kanë patur lidhje me marrëdhëniet e shtetit shqiptar me këto dy shtete. Në punim pasqyrohet dhe roli që pati shteti italian në zhvillimin e ekonomisë shqiptare. Pjesë e këtij punimi janë dhe marrëdhëniet e shtetit shqiptar me Turqinë dhe Greqinë, marrëdhënie të cilat u shoqëruan me peripeci të shumta. Tema merr në analizë dhe përpjekjet për të vendosur marrëdhënie me Rumaninë dhe Bullgarinë.

Kjo temë, sot ka nevojë për fakte të reja historike dhe interpretime bashkëkohore.

Mendoj se ky punim do të jetë një kontribut modest për rishikimin e politikës së jashtme shqiptare gjatë viteve 1925-1928, parë në një këndvështrim të ri, në atë të karakterit balancues të saj. Gjithashtu studimi merr vlerë dhe nga trajtimi i marrëdhënieve të shtetit shqiptar me shtetin rumun dhe atë bullgar, një temë shumë pak e trajtuar deri më sot.

Punimi vjen si pasojë e një pune disavjeçare në kuadrin e kërkesave për rishikimin dhe riinterpretimin e ngjarjeve të veçanta të historisë, e bërë kjo nën dritën e dokumenteve arkivore, objektivitetit të historianëve shqiptarë dhe pikëpamjeve të studiuesve të huaj.

## **II – QËLLIMI I STUDIMIT DHE TEZA MBIZOTËRUESE**

Një nga qëllimet kryesore është evidentimi dhe studimi i tiparit kryesor të politikës së jashtme shqiptare, të atij tipari që e bëri atë të suksesshme, i cili është karakteri ekuilibruar i politikës adriatiko-ballkanike të politikës shqiptare në lidhje me pozicionin e Shqipërisë në Ballkan dhe në Mesdhe. Të vihen në dukje rrethanat në të cilat u krijua Republika Shqiptare, funksionet dhe organizimi i brendshëm i saj. Të evidentohen shkaqet që e detyruan qeverinë shqiptare të orientohej në politikën e jashtme drejt Italisë. Të njihen pasojat e Paktit të Parë dhe të Dytë të Tiranës për qeverinë shqiptare dhe impakti i tyre në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave.

Të evidentohet nevoja e krijimit të Bankës Kombëtare Shqiptare dhe e marrjes së huasë SVEA dhe gjithashtu roli që ato patën në zhvillimin e ekonomisë shqiptare të këtyre viteve. Të vlerësohen përpjekjet që bëri Ahmet Zogu për nxitjen e investimeve të shoqërive të huaja në Shqipëri dhe të njihet rëndësia e investimeve që u bënë në fushën e naftës.

Të dalin në pah tentativat e vazhdueshme të qeverisë shqiptare për ta zgjidhur çështjen e Shën Naumit në favorin e saj dhe roli që pati faktori ndërkombëtar në zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështjeje. Të evidentohen tentativat jugosllave për barazimin e influencimit ekonomik në Shqipëri. Të njihen pasojat e politikës jugosllave në Shqipëri dhe ndikimi i kësaj politike në marrëdhëniet shqiptaro-italiane.

Të vlerësohen të gjitha përpjekjet e qeverisë shqiptare për mbrojtjen e popullsisë çame dhe të njihet qëndrimi i Fuqive të Mëdha ndaj padrejtësive të bëra në kurriz të kësaj popullsie. Të njihet rëndësia që patën për shtetin shqiptar marrëveshjet me shtetin grek dhe pozicioni që ky i fundit mbajti në zgjidhjen e problemeve me shtetin e vogël fqinj.

Të dalë në pah ndikimi i Traktatit të Miqësisë, të nënshkruar midis qeverisë shqiptare dhe asaj turke për përmirësimin e pozitës së popullsisë shqiptare në Turqi. Të vlerësohet rëndësia e vendosjes së marrëdhënieve me shtetin rumun dhe atë bullgar.

**Teza mbizotëruese.** Të njihet rëndësia e ekuilibrit të politikës adriatiko-ballkanike të qeverisë shqiptare, një nevojë e cila i shërbente mbijetesës së shtetit shqiptar në këtë periudhë dhe i cili e lejoi atë të ecte përpara. Të vlerësohet roli që patën paktet me Italinë në mbrojtjen nga sulmet jugosllave dhe në mbrojtjen e pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të Shqipërisë. Të njihet impakti pozitiv që patën për ekonominë shqiptare investimet italiane në fusha të ndryshme në Shqipëri dhe investimet e shteteve të huaja. Të vihet në dukje karakteri keqdashës i politikës jugosllave ndaj qeverisë shqiptare. Të evidentohen hapat e bërë dhe rëndësia e politikës shqiptare në raport me shtetin grek dhe atë turk për zgjidhjen e problemeve që haste popullsia shqiptare në këto dy shtete. Të vihen në dukje qëllimet e mira të qeverisë shqiptare për të vendosur marrëdhënie dhe me shtetet e tjera të rajonit ballkanik, Rumaninë dhe Bullgarinë.

### III – METODIKA E PËRDORUR PËR REALIZIMIN E STUDIMIT

Metodologjia kryesore e përdorur në këtë punim shkencor është bazuar në njohjen dhe vlerësimin e burimeve arkivore vendase dhe të huaja, në vlerësimin e literaturës historigrafike shqiptare dhe të huaj të shkruar deri në ditët e sotme, në gjetjen dhe vlerësimin e botimeve dokumentare vendase dhe të huaja, në vlerësimin e shtypit të kohës, e bërë kjo përmes hulumtimit të tyre, e gërshetuar me qasjen tematike, përshkrimin dhe krahasimin, duke pasur si kriter bazë besueshmërinë dhe vërtetësinë e tyre. Gjithashtu dhe paanshmëria në interpretimin e dokumenteve, ballafaqimi dhe krahasimi i qëndrimeve është një pjesë e rëndësishme e këtij punimi.

#### IV - BAZA BURIMORE

Punimi është mbështetur në një material të konsiderueshëm arkivor. Për një trajtim me nivel shkencor të kësaj periudhe jemi mbështetur në dokumentet arkivore të Arkivit Qendror Shtetëror (AQSH), veçanërisht në fondet: 146, 246 (Parlamenti); 149, 249 (Kryeministria); 151, 251 (Ministria e Punëve të Jashtme); 152, 252 (Ministria e Punëve të Brendshme); 163, 263 (Legata italiane); 178 (Ministria e Financave); 179 (Banka Kombëtare e Shqipërisë) dhe 195 (Ministria e Arsimit). Janë shfrytëzuar dhe burime në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme (AMPJ) dhe në Arkivin e Institutit të Historisë (AIH).

Për një interpretim më të saktë dhe të paanshëm të ngjarjeve janë hulumtuar dhe burimet arkivore të huaja, ndër të cilat përmendim The National Archives, Londër.

Janë shqyrtuar me kujdes disa botime dokumentare vendase, si: “Dokumente për Çamërinë 1912-1939” përgatitur nga Kaliopi Naska, botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, Tiranë, 1999; “Mid’hat Frashëri. Ministër Fuqplotë në Athinë (1923-1926)” përgatitur nga Luan Malltezi dhe Sherif Delvina, Tiranë, 2002; “Shën Naumi dhe diplomacia e kohës” përgatitur për botim nga Kaliopi Naska, Tiranë, 2012 etj. Gjithashtu janë analizuar dhe një sërë botimesh dokumentare të huaja, ndër të cilat veçojmë: “Documenti Diplomatici Italiani, Settima serie (1922-1935), vol. III (23 febbraio 1924-14 maggio 1925)”, Roma, 1959; “Documenti Diplomatici Italiani, Settima serie (1922-1935), vol. IV (15 maggio 1925-6 febbraio 1927)”, Roma, 1962; “Documenti Diplomatici Italiani, Settima serie (1922-1935), vol. V (7 febbraio-31 dicembre 1927)”, Roma, 1967; “Documenti Diplomatici Italiani, Settima serie (1922-1935), vol. VI (1 gennaio – 23 settembre 1928)”, Roma, 1967; “Documents on British Foreign Policy (1919-1939), First Series, vol. XXVI”, London, 1985; “Documents on British Foreign Policy, First Series, vol. XXVII”, London, 1984-1986; “Documents on British Foreign Policy (1919-1939), Series IA, vol. II, The termination of military control in Germany, Middle Eastern and American questions, 1926-1927”, London, 1968; “Documents on British Foreign Policy (1919-1939), Seria IA, vol. IV, European and security questions, (1927-1928)”, London, 1971; “Un Decennio di vita della SVEA”, Roma, 1936 etj.

Kemi vlerësuar dhe shkrimet e bëra në shtypin vendas dhe të huaj ku përmendim: revista “Albania”, Romë, 1943; revista “Albania News”, Romë, 2012; gazeta “Besa”, Tiranë, 1933; gazeta “Bisedimet”, Kajro, 1925; gazeta “Bisedimet e Kuvendit Kushtetues”, Tiranë, 1925; gazeta “Demokratia”, Gjirokastër, 1926, 1927, 1928; gazeta “Dielli”, Boston Mass., 1925, 1927; gazeta “Drita”, Gjirokastër, 1923; gazeta “E drejta”, Stamboll, 1924; revista “Fletorja Zyrtare”, Tiranë, 1925, 1926; “Gazeta e Korçës”, Korçë, 1924, 1925, 1926; “Gazeta Shqiptare”, Bari, 1927, 1928; revista “I petroli dell’Albania”, Romë, 1942; “La rivista italiana del petrolio”, Romë, 1937; revista “L’Industria ed il Commercio Italo-Albanese”, Milano, 1928; gazeta “Liria Kombëtare”, Kostancë, 1934; gazeta “Politika”, Beograd, 1925, 1927; gazeta “Shqipëri e Re”, Kostancë, 1926, 1927, 1928 etj.

Një ndihmë të madhe në trajtimin me argumente shkencore të temës time më ka dhënë dhe literatura shumë e pasur shqiptare. Të tilla botime janë: “Institucionet politike dhe e drejta kushtetuese në Shqipëri (1912-1939)” shkruar nga Aurela Anastasi, Tiranë, 1998; “Diplomacia dhe diplomatët shqiptarë 1912-1944” me autor Uran Asllanin, Tiranë, 2006; “Politika zogiste e dyerve të hapura në v.1925-1926” nga Mentar Belegu, Studime historike, Tiranë, 1964; “Marrëdhëniet shqiptaro-italiane në vitet 1920-1934” me autor Arben Cicin, Tiranë, 2002; “Historia e shtetit shqiptar 1912-2005” shkruar nga Kastriot Dervishi, Tiranë, 2006; “Histori e Shqipërisë 1912-2000” nga Valentina Duka, Tiranë, 2007; “Ndërhyrja italiane në Shqipëri

(1925-1939)” me autor Ramiz Fiçorin, Tiranë, 2005; “Kujtime (1913-1933)” nga Mehdi Frashëri, Tiranë, 2005; “Historia e popullit shqiptar, vëll. III” botuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2007; “Historia e Bankës Qendrore në Shqipëri”, Tiranë, 2003; ”Disa të dhëna historiografike për origjinën, popullsinë dhe vendbanimet e vllahëve”, Studime historike, Nr.1-2, “Politika tatimore e shtetit shqiptar 1925-1939”, “Tragjedia çame” dhe “Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri (1912-1924)” shkruar nga Beqir Meta, Tiranë, 2011, 1999, 2007, 2013; “Politika e jashtme e Shqipërisë, vëll.I” dhe “Shqipëria dhe Jugosllavia (1918-1927)” me autor Paskal Milon, Tiranë, 2013, 1992; “Veprimtaria diplomatike e Mithat Frashërit në Athinë (1923-1926)”, Studime historike, Nr.1-2 dhe “Republika Shqiptare (1925-1928)” nga Fatmira Musaj, Tiranë, 2006, 2018; “Demokracia e rrethuar”, “Historia diplomatike e çështjes shqiptare” dhe “Shqipëria politike 1912-1939” shkruar nga Arben Puto, Tiranë, 2010, 2003, 2009; “Problemi çam në Lidhjen e Kombeve (1923-1926)” nga Fatmira Rama, Studime historike, Nr 1-2, Tiranë, 2007; “Shqipëria dhe diplomacia angleze 1919-1927” shkruar nga Pranvera Teli, Tiranë, 2005; ” Kontradiktat e fuqive imperialiste për akaparimin e vajgurit në Shqipëri pas luftës së parë botërore”, Studime historike, Nr.2 dhe “Projektet dhe orvatjet imperialiste për zotërimin e tregut shqiptar të monedhës dhe kreditit dhe lufta kundër tyre (1920-1924)”, Studime historike, Nr.2 me autor Veniamin Toçin, Tiranë, 1966, 1968; “Diplomacia e mbretit Zogu i I (1912-1939)” nga Ilir Ushtelenca, Tiranë, 1997; “Rauf Fico-Shtetar dhe diplomat i shquar” shkruar nga Shyqyri Hysi, Tiranë, 2007; “Sistemi monetar dhe i kreditit në Shqipëri (1925-1944)” me autor Iljaz Fishtën, Tiranë, 1971 etj.

Nga literatura e autorëve të huaj veçojmë: “Bullgaria dhe Shqipëria nga shpallja e pavarësisë deri në fillimin e luftës së dytë botërore 1912-1939”, 100 Vjet Pavarësi, Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare, vëll II, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, nga Bobi Bobev, Tiranë, 2014; “Ahmet Zogu, Mbreti shqiptar midis dy lufrave” dhe “Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri” shkruar nga Bernd J. Fischer, Tiranë, 2009, 2004; “Çamët myslimanë të Epirit (1923-2000)” nga Eleftheria Manda, Tiranë, 2015; “Bashkëpatriotë të padëshiruar - Të dhëna mbi shkatërrimin e minoriteteve të Greqisë: hebrenjtë, çamët” me autor Jorgos Margaritis , Tiranë, 2009; “Serbo-Albanian Bank in Albania 1925-1927”, Balcanica, issue XXXVII nga Saša Mišić, Beograd, 2007; “Shqipëria përballë Europës (1912-1929)” shkruar nga Albert Mousset, Tiranë, 2004; ”The diplomacy of Theodoros Pangalos 1925-1926”, Balkan Studies, Vol.13, Nr.1 me autor Harry J. Psomiades, Selanik, 1972; “Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit të XX” nga Nina Smirnova, Tiranë, 2004; “Shqipëria, ngritja e një mbretërie” shkruar nga Joseph Swire, Tiranë, 2005; “Principi di Economia Albanese” me autor Filippo Tajani, Padova, 1941; ”Sir Austen Chamberlain and the Italo-Yugoslav Crisis over Albania February-May 1927”, Balcanica, issue XXXVI nga Jovan Zametica , Beograd, 2006 etj.

## V - STRUKTURA E PUNIMIT

Materiali studimor është ndërtuar duke ndërthurur kriterin kronologjik me atë tematik. Duke u mbështetur në këto kritere, punimi me temë “Politika adriatiko-ballkanike e Ahmet Zogut në vitet 1925-1928” përbëhet nga : parathënia, hyrja, pesë kapitujt, përfundimet dhe bibliografia.

Në **hyrje** flitet për padrejtësitë që iu bënë shtetit shqiptar që nga mosnjohja e qeverisë së Vlorës, caktimi i kufijve në vitin 1913, pretendimet territoriale të shteteve fqinje ndaj shtetit shqiptar gjatë regjimit të Vilhelm Vidit dhe krijimi i katër zonave të pushtimit gjatë Luftës së Parë Botërore. Gjatë Konferencës së Paqes në Paris do të vihej re se si do të shkelej pavarësia dhe sovraniteti i Shqipërisë. Sikur të mos mjaftonte copëtimi i këtij shteti në Konferencën e Ambasadorëve në Londër në vitin 1913, edhe në këtë Konferencë shtetet fqinje dalin me pretendime të tjera në përpjekje për t’i shkëputur territore të mëtejshme shtetit shqiptar. Pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve përveçse pati rëndësi për njohjen e shtetit shqiptar dhe të sovranitetit të territorit të tij, ai i preu rrugën shteteve fqinje për copëtimin e tokave shqiptare. Gjithashtu në drejtim të konsolidimit të pozitës së shtetit shqiptar në arenën ndërkombëtare shërbeu dhe vendimi i 9 nëntorit 1921. Ky vendim pati si rrjedhojë njohjen e qeverisë shqiptare dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike të vendeve të tjera me Shqipërinë. Në vitet 1921-1924 situata e brendshme politike në Shqipëri shfaqej shumë e paqëndrueshme. Pikërisht kjo situatë u shfrytëzua për të sjellë në pushtet Nolin përmes Kryengritjes së Qershorit. Pavarësisht dëshirës së mirë të tij për të vendosur marrëdhënie diplomatike me vendet e tjera, qeveria e Nolit nuk u njoh prej tyre, pasi ato kuptuan se interesat e tyre politike dhe ekonomike nuk mund të realizoheshin për aq kohë sa Noli do të qëndronte në pushtet. Qeveria demokratike e Nolit u njoh vetëm nga sovjetikët. Vështirësitë që hasi Noli në drejtimin e vendit, mungesa e fondeve, përçarja e qeverisë së tij, mospërkrahja e brendshme dhe mosnjohja e qeverisë së tij në sferën ndërkombëtare u shfrytëzuan nga Zogu për t’u rikthyer në pushtet, rikthim në të cilin ndikuan fuqishëm për hir të interesave të tyre Jugosllavia dhe Britania e Madhe.

### KREU I

#### **PRESIONI ITALIAN DHE ORIENTIMI POLITIK I SHQIPËRISË DREJT ITALISË NË VITET 1926-1928**

Në kreun I paraqitet situata në Shqipëri pas ardhjes së Ahmet Zogut në pushtet dhe nevoja e hedhjes së themeleve të një shteti të fortë. Ndër veprimet e para që Zogu ndërmori ishte shpallja e Republikës, dhe duke bërë një miks të sistemit Parlamentar me atë Presidencial arriti të përqëndronte të gjithë pushtetin në duart e tij. Ai njëkohësisht hartoi dhe kushtetutën sipas modelit amerikan dhe përmes zgjedhjeve mundi të legalizonte pozitën e qeverisë. Në krijimin e strukturave të shtetit, Zogu u mundua të merrte shembujt më të mirë të kohës, modelin francez për një administratë të centralizuar, atë italian në fushën ligjore dhe atë anglez në fushën ushtarake. Ai ndërmori reforma të thella në çdo hallkë të shtetit dhe bëri një punë shumë të mirë për të luftuar problemet kryesore të vendit. Brenda një kohe të shkurtër ai ia doli të vendoste rendin dhe qetësinë dhe të minimizonte gjakmarrjen dhe mosrespektimin e ligjit. Një ndër veprimet më të vlerësuara nga studiuesit ishte dhe unifikimi i shtetit. Në këtë pjesë flitet dhe për tentativat e Zogut për zbatimin e një politike të pajtimit kombëtar, për të cilën nuk pati shumë sukses.

Ahmet Zogu duke qënë i vetëdijshëm se për t'a futur vendin në rrugën e zhvillimit i duhej ndihma e huaj, e hodhi vështrimin tek dy shtetet që ishin më të interesuara për Shqipërinë, Italia dhe Jugosllavia. Megjithë luhajteve të para që pati, duke qënë se Jugosllavia e kishte ndihmuar të vinte në pushtet, ai mendonte se nëse do të mbështetej tek Jugosllavia do të ishte më i ekspozuar ndaj problemeve, prandaj preferoi Italinë. Në këtë periudhë shteti italian kërkonte mosndërhyrjen e një fuqie të huaj në bregun tjetër të Adriatikut dhe kthimin e Shqipërinë në një bazë për të ushtruar rolin e Fuqisë së Madhe në Ballkan. Pasi Italia bëri depërtimin në fushën ekonomike të Shqipërisë, do të kërkonte të zotëronte edhe fushat e tjera të saj. Në këtë kre flitet dhe për presionet e vazhdueshme të qeverisë italiane ndaj shtetit shqiptar për të nënshkruar Paktin e Parë të Tiranës, për të arritur qëllimet e saj dhe orientimin e detyruar të Shqipërisë ndaj Italisë në politikën e jashtme. Ndërkohë interesi italian mbi shtetin shqiptar përpiquej të shfrytëzohej nga Zogu për të marrë një garanci kundrejt një ndërhyrjeje të mundshme ushtarake të Jugosllavisë. Gjatë kësaj periudhe vërehet se Zogu arrin të luajë shumë bukur në fushën diplomatike me këto dy shtete, pasi nëse në njërin anë përpiquej të mbrohej nga Jugosllavia përmes Italisë, në anën tjetër ai bënte tentativa herë pas here që të orientohej dhe drejt Beogradit, në mënyrë që mos ishte totalisht i varur nga Italia dhe gjithashtu duke patur si qëllim të balanconte presionet që i vinin nga të dyja palët. Në këtë kontekst përmendim propozimin që ai i bëri ministrit të jashtëm jugosllav, Ninçicit, përpara nënshkrimit të Paktit të Parë të Tiranës, për një pakt miqësie midis dy vendeve. Me nënshkrimin e Paktit të Parë të Tiranës, më 27 nëntor 1926, nenet më të diskutuara të tij ishin dy të parat, pasi i pari obligonte Italinë të mbronte statuskuonë politike, juridike dhe territoriale të Shqipërisë duke nënkuptuar dhe ndërhyrjen e saj në punët e brendshme të shtetit shqiptar, ndërsa i dyti e detyronte Shqipërinë të mos sillej si një shtet i pavarur në planin ndërkombëtar, përderisa nuk mund të lidhte me shtete të tjera marrëveshje politike dhe ushtarake.

Mendohej se Jugosllavia po përgatiste një sulm në kufijtë shqiptarë, me qëllim krijimin e turbullirave dhe rrëzimin e regjimit. Në këto kushte meqënëse garancia e dhënë nga Pakti i Parë i Tiranës nuk mjaftonte për ta mbrojur Shqipërinë nga sulmet e jashtme, lindte nevoja e një alence të re. Në këtë kapitull vihet re dhe roli i Britanisë së Madhe në përpjekjen për të stabilizuar marrëdhëniet italo-jugosllave. Në këto marrëdhënie ajo mbante anën e Italisë, ndërsa për të qetësuar palën jugosllave, i sugjeronte asaj se duhej të ishte ajo e para që të kërkonte bisedime me qeverinë italiane. Franca më 11 nëntor 1927 nënshkruan një marrëveshje alence me Jugosllavinë me qëllim që të frenonte politikën italiane në Shqipëri dhe më gjërë, në Ballkan, dhe gjithashtu për të forcuar pozitat e aleates së saj, Jugosllavisë. Përgjigja e Mussolini-t ishte e menjëhershme, nxitja e Zogut për nënshkrimin e Paktin të Dytë të Tiranës, më 22 nëntor 1927, pakt të cilin Mussolini e kishte thurur kohë më parë. Përmes tij Shqipëria në rast të ndonjë sulmi të jashtëm kishte mundësinë që të tërhiqte dhe Italinë në luftë. Kështu Shqipërisë përveç mbrojtjes së Lidhjes së Kombeve iu shtua dhe mbrojtja e shtetit italian.

## **KREU II**

### **ORIENTIMI I EKONOMISË SË SHQIPËRISË DREJT ITALISË NË VITET 1925-1926**

Kreu II përbëhet nga disa pjesë ose nënkapituj. Në pjesën e parë flitet për përpjekjet e shtetit shqiptar për të gjetur rrugë dhe alternativa të ndryshme për të nxitur zhvillimin ekonomik të vendit. Nevoja më urgjente për shtetin shqiptar në këtë kohë ishte krijimi i një Banke

Kombëtare, e cila mungonte në Shqipëri dhe e cila do të mund të rregullonte gjendjen financiare, të jepte kredi në fusha të ndryshme dhe të hidhte në qarkullim një monedhë të vetme, duke zhvlerësuar monedhat e ndryshme që përdreshin në zona të ndryshme të Shqipërisë. Kështu, më 2 shtator 1925 në marrëveshje me grupin financiar italian “Credito Italiano”u krijua Banka Kombëtare me një kapital 12.5 milion franga ari për 50 vite. Këtu ndikoi dhe rekomandimi i Lidhjes së Kombeve, e cila e shihte Shqipërinë si një zonë influence e Italisë. Romës, nga ana tjetër i interesonte të ndihmonte shtetin e vogël fqinjë për hir të interesave të saj, dominimit ekonomik dhe politik në Shqipëri. Banka ndihmoi me dhënien e disa kredive shtetit shqiptar, duke patur një rol me rëndësi në zhvillimin ekonomik të vendit, por ajo njëkohësisht do t’i shërbente edhe interesave italiane.

Në pjesën e dytë trajtohet gjendja e rëndë ekonomike në të cilën ndodhej Shqipëria. Për të dalë nga kjo situatë fillimisht qeveria shqiptare u fokusua tek rritja e taksave, por kjo masë do të ishte e pamjaftueshme. Kështu, rruga e vetme mbetej marrja e një huaje. Huaja SVEA ishte 50 milion franga ari dhe do të shlyhej për 40 vjet me një përqindje interesi 7.5 %. Meqënëse Shqipëria ishte një vend bujqësor, mendohej se këtij sektori do t’i kushtohej më tepër rëndësi, sikurse dhe pasqyrohej në programin e parë të zbatimit të huasë, në të cilin parashikohej që gjysma e fondit të shkonte për bujqësinë. Por në fakt, në programin e tretë vetëm një përqindje shumë e vogël e huasë do të shkonte për këtë sektor, duke u përqëndruar më shumë tek ndërtimi i rrugëve dhe urave. Kjo sepse si problem kryesor në këtë kohë doli çështja e komunikacioneve. Përmes ndërtimit të rrugëve dhe urave do të bëhej lidhja ekonomike e zonave të brendshme të vendit. Në të njëjtën kohë, në ndryshimin e drejtimit të përdorimit të huasë SVEA luajtën një rol të madh dhe interesat italiane në Shqipëri dhe më gjerë, në Ballkan.

Në pjesën e tretë flitet për tensionin në marrëdhëniet italo-britanike në lidhje me koncesionet e naftës në Shqipëri. Mendohej se në territorin shqiptar ishin zbuluar sasira të shumta naftë dhe si rezultat i kësaj Ahmet Zogu do të përpiqet të shfrytëzojë situatën për të rritur interesin e shteteve të ndryshme për të investuar në Shqipëri. Në vitin 1921 shteti shqiptar kishte nënshkruar një marrëveshje me D'Arcy Exploration, një degë e kompanisë Anglo-Persiane dhe si pasojë Britania e Madhe kërkonte të kishte primatin në këtë fushë. Lufta për koncesione do të ishte më e ashpër midis Italisë dhe Britanisë së Madhe dhe gjatë kësaj kohe për këtë çështje u arrit kulmi i acarimit të marrëdhënieve midis tyre. Diplomacia italiane ushtronte presion të vazhdueshëm mbi qeverinë shqiptare për mosratifikimin e kërkesës së shoqërisë angleze. Gjithashtu ajo shprehu hapur dhe pakënaqësitë ndaj qeverisë angleze. Debatu bëhej për një sipërfaqe prej 4.000 ha, nga 40.000 ha që ishte kërkuar nga shteti italian për kompaninë italiane të hekurudhave, sipërfaqe e cila bënte pjesë në koncesionin e dhënë shoqërisë angleze. Koncesioni i shoqërisë angleze u ratifikua më 16 shkurt 1925 dhe asaj iu dha një sipërfaqe prej 200.000 ha me të drejtë shfrytëzimi në 50.000 ha. Gjithsesi në kuadër të interesave më të gjera në sferën europiane që Britania e Madhe kishte, ajo u detyrua të tërhiqej dhe t’i hapte rrugë kapitalit italian dhe në këtë fushë, ashtu siç ndodhi dhe me çështjen e bankës. Më 10 mars 1925 qeveria shqiptare i dha Hekurudhave Shtetërore Italiane koncesionin për eksplorimin e naftës në 50.000 ha me të drejtë shfrytëzimi në 30.000 ha. Në këtë çështje diskutohet dhe për koncesionet që iu dhanë kompanive të tjera të huaja si: Standart Oil Company, grupit Rushton, Credit General des Petroles et.j

Në pjesën e katërt tregohet për veprimtarinë e AIPA-s (“Ndërmarrja Italiane e Naftës së Shqipërisë”) në Shqipëri, e cila u krijua për administrimin e koncesionit të Hekurudhave Shtetërore Italiane, koncesion që u dha për 70 vite. Pranë saj punuan inxhinierë të njohur të kohës si: Leo Maddalena, Giovanni Ineichen, Cesare Porro, Stanislao Zuber etj. Stanislao Zuber

arriti të hartonte hartën tektonike të Shqipërisë me shkallë 1:400.000. Nën drejtimin e tij u modifikua dhe teknika e shpimit dhe filloi të përdorej procesi i hidrogenizimit, i cili shërbente për të përmirësuar karakteristikat e produktit, meqënëse nafta shqiptare kishte një përqindje të lartë asfalti dhe squfuri. AIPA arriti që t'a zgjeronte sipërfaqen e marrë në koncesion dhe përmirësoi dhe kushtet e koncesionit. Punimet e saj nisën fillimisht në zonën bregdetare dhe më pas u zhvendosën në brendësi të vendit.

### **KREU III**

#### **MARRËDHËNIET POLITIKE DHE EKONOMIKE TË REPUBLIKËS SHQIPTARE ME JUGOSLLAVINË NË VITET 1925-1928**

Kreu III përbëhet nga katër pjesë dhe trajton zhvillimet dhe problematikat në fushën politike dhe ekonomike midis këtyre dy vendeve. Në pjesën e parë flitet për çështjen që kishte mbetur ende pezull midis shtetit shqiptar dhe atij serb, atë të Shën Naumit. Shën Naumi që nga viti 1912 ishte nën pushtimin serb në bazë të pretendimeve fetare që serbët kishin për manastirin. Bashkë me Shën Naumin Serbia ndoqi dhe çështjen e rishikimit të kufirit në Vermosh, megjithëse për të nuk kishte argumenta etnike ose historike. Kërkesa e saj për Shën Naumin buronte nga marreveshja që ishte bërë me Zogun para se ai të vinte në pushtet. Instancat ndërkombëtare të kohës, Konferenca e Ambasadorëve, Lidhja e Kombeve dhe Dhoma e Përhershme e Hagës, kishin vendosur në favor të Shqipërisë por Jugosllavia e kishte kundërshtuar vendimin disa herë. Gjithashtu u bë propozimi që për zgjidhjen e çështjes, të dyja palët të hynin në bisedime të drejtpërdrejta, të cilat do të dështonin shumë shpejt. Gjatë kësaj kohe nga qëndrimi që mbajti, të krijohet përshtypja se Konferenca e Ambasadorëve nuk kishte fuqinë e duhur për t'a detyruar Jugosllavinë të respektonte vendimin e saj. Në prill 1925 ajo vendosi që Shën Naumi i "përkiste Shqipërisë", por vendimi i linte liri veprimi palës jugosllave. Problemi u zgjidh me ndërhyrjen e Konferencës së Ambasadorëve dhe më pas u bënë shkëmbimet territoriale. Më 30 korrik 1926 u arrit të përcaktoheshin kufijtë e Shqipërisë.

Në pjesën e dytë paraqiten përpjekjet e kapitalit jugosllav për të rivalizuar me atë italian në fushën ekonomike të Shqipërisë. Jugosllavia në funksion të ndërmarrjes së veprimeve të përbashkëta ekonomike në Shqipëri, tentoi që të kishte një ndikim të barabartë me palën italiane në çështjen e krijimit të bankës kombëtare. Kjo vihet re kur palës italiane iu propozua që të merrte pjesë në krijimin e bankës serbo-shqiptare dhe në dhënien bashkarisht të një huaje shtetit shqiptar, duke eliminuar ndikimin britanik. Synimi i saj ishte kthimi i kësaj banke në një bankë qendrore të Shqipërisë. Banka Serbo-Shqiptare hapi një filial të saj në qytetin e Shkodrës me një kapital prej 10 milion dinarësh, pothuajse në të njëjtën kohë kur u krijua dhe Banka Kombëtare e Shqipërisë. Dhënia në koncesion e Bankës Kombëtare të Shqipërisë italianëve u shoqërua me shpresën e jugosllavëve që kapitali i tyre të përfaqësohej në të një mënyrë të barabartë me atë italian. Më pas ata bënë përpjekje për të penguar ratifikimin e koncesionit nga qeveria shqiptare. Grupit të bankave jugosllave iu dha vetëm 10 % e aksioneve të kësaj banke. Gjithashtu edhe shpresa e tyre e fundit për të marrë dhe pjesën e aksioneve shqiptare në mënyrë që të merrnin kontrollin e bankës u shua shumë shpejt. Ndërkohë filiali i bankës serbo-shqiptare pati probleme financiare dhe e humbi konkurrencën në fushën bankare me kapitalin italian. Pas dështimit në çështjen e bankës, kapitali jugosllav u përpoq të merrte koncesione dhe në fusha të tjera, si: në industri, në komunikacion, në peshkim etj. Ai mori një koncesion për kërkimin e bakrit në Pukë për 50 vjet, të cilin e humbi si pasojë se nuk mundi të grumbullonte dot kapitalin e paracaktuar dhe si pasojë e ndërhyrjes së kapitalit italian, kapitali i cili e nxorri jashtë loje atë dhe në fushën e

transporteve. Në këtë pjesë trajtohet gjithashtu dhe nënshkrimi i traktatit të tregtisë dhe lundrimit midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, me qëllim zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike midis tyre. Traktati tregtar u shoqërua nga marrëveshja konsullore dhe ajo e ekstradimit.

Në pjesën e tretë vërehet pakënaqësia e Beogradit ndaj politikës së Zogut dhe fokusimi i tij tek emigracioni politik shqiptar, si mjet për t'a bërë Zogun të reflektojë dhe të marrë parasysh interesat jugosllave, pra si një mjet presioni në favor të politikës së tij. Më 20 nëntor të vitit 1926 shpërtheu ajo që njihet me emrin kryengritja e Dukagjinit. Në lidhje me diskutimin rreth origjinës së kryengritjes, Italia dhe Jugosllavia përfituan të akuzonin njëra-tjetrën si nxitësë të saj. Versioni më i besueshëm ishte ai që ia ngarkonte Jugosllavisë fajin në organizimin e kryengritjes, përmes së cilës ajo synonte të trembte Zogun, pasi ai i kishte braktisur interesat e e Beogradit në Shqipëri. Gjithashtu mendohej se dhe Roma kishte ndikimin e saj në këtë kryengritje, megjithëse ishte jo i drejtpërdrejtë, pasi rezultonte se ajo ishte në dijeni të organizimit të saj, por e shfrytëzoi atë më së miri për të shtyrë Zogun që të firmoste Paktin e Parë të Tiranës.

Në pjesën e katërt shqyrtohet hartimi i një plani nga Jugosllavia, përmes të cilit, me ndihmën e përkrahësve të politikës jugosllave ajo do të zëvendësonte Ahmet Zogun me një element që do favorizonte interesat e kësaj politike në Shqipëri. Ky plan nuk gjeti dot zbatim. Kur marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave po shkonin drejt normalizimit, ngjarja e radhës do t'i çonte ato drejt acarimit. Në këtë kohë u arrestua një shtetas shqiptar me kombësi malazeze, Vuk Gjurashkoviç, i cili pretendonte se ishte punonjës i legatës jugosllave në Tiranë, por në fakt ai i shërbentë spiunazhit jugosllav në Shqipëri. Me arrestimin e tij u zbuluan dhe materiale të cilat kompromentonin figurën e Ceno bej Kryeziut. Në qershor 1927 marrëdhëniet diplomatike midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë u ndërpre. Me ndërhyrjen e Fuqive të Mëdha incidenti u zgjidh dhe në gusht marrëdhëniet u rivendosën. Kriza tjetër në marrëdhëniet Shqipëri-Jugosllavi do të shkaktonte nga vrasja e Ceno bej Kryeziut, ministrit Fuqiptotë në Beograd, për të cilin dyshimet se ishte një agjent jugosllav ekzistonin dhe më parë, por që u vërtetuan plotësisht nga materialet që iu gjetën Gjurashkoviçit. Për hir të këtyre dyshimeve aktiviteti i tij në Beograd vëzhgohej gjatë gjithë kohës nga Zogu dhe italianët. Për vrasjen e tij më 14 tetor 1927 në Pragë pala jugosllave akuzonte Italinë.

#### **KREU IV**

### **MARRËDHËNIET E SHQIPËRISË ME GREQINË NË VITET 1925-1928**

Kreu IV pasqyron origjinën dhe zhvillimin e çështjes çame dhe marrëveshjet e nënshkruara gjatë kësaj kohe midis shtetit shqiptar dhe atij grek. Greqia në këtë kohë në bazë të marrëveshjes që kishte bërë me shtetin turk në janar të vitin 1923 në lidhje me shkëmbimin e popullsisë, nisi procesin e shpërnguljes së popullsisë myslimane shqiptare nga trojet e saj për në Turqi. Megjithëse qeveria greke i njihte çamët si minoritet shqiptar, interesave të saj u leverdiste që duke u bazuar tek feja ti ngatërronte ata me turqit. Shpërngulja e parë e popullsisë ishte ajo e vitit 1923, e 35.000 banorëve nga fshatrat shqiptare të Kosturit dhe Follorinës, të cilëve iu konfiskua pasuria. Më pas filloi trysnia dhe mbi zonën e Çamërisë. Kriteret që u vendosën për përcaktimin e popullsisë për shkëmbim nuk u respektuan. Qeveria shqiptare në përpjekje për të ndryshuar situatën, shumë herë deklaroi në Lidhjen e Kombeve se nëse do të dëboheshin shqiptarët myslimanë nga Çamëria, ajo do të dëbonte minoritarët grekë nga Shqipëria. Lidhja e Kombeve gjatë kësaj kohe ishte e prirur për ta trajtuar problemin e popullsisë myslimane

shqiptare në Greqi në kuadrin e marrëdhënieve greko-turke, duke iu referuar traktatit turko-grek për mbrojtjen e minoriteteve, të gushtit të vitit 1920. Rrugët që shteti grek përdori për të shpërngulur popullsinë shqiptare ishin nga më të ndryshmet, si: përdorimi i dhunës mbi popullsinë që bënte rezistencë; konfiskimi i pasurisë; presionet e ndryshme; korruptimi i disa myftinjve; çkurajimi i shqiptarëve përmes procedurave të gjata burokratike etj.

Në këtë çështje trajtohet gjithashtu dhe problemi i pasurive shqiptare në Greqi dhe ai i të drejtave të minoritetit shqiptar atje. Qeveria shqiptare ishte përpjekur disa herë të bisedonte me palën greke dhe disa herë kishte dërguar përfaqësues të saj në Lidhjen e Kombeve në lidhje me këto dy probleme. Gjatë kësaj periudhe shikohet dhe qëndrimi i vakët që Lidhja e Kombeve mban ndaj çështjes çame.

Në pjesën e dytë të këtij kapitulli flitet se në kuadrin e zhvillimit të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Greqisë u nënshkruan disa marrëveshjeve tregtare e lundrimi, konsullore, nënshtetësie dhe ekstradimi. Me anë të marrëveshjes së ekstradimit, të nënshkruar më 25 qershor 1926 të dyja shtetet binin dakord në lidhje me procedurat e ekstradimit të individëve, të cilët kishin kryer krime në këto dy vende. Ekstradimi nuk do të bëhej për krime politike, për krime ushtarake dhe gjithashtu nëse shkelja e ligjit kishte karakter fiskal. Me rrëzimin e Pangalos-it nga pushteti në gusht të vitit 1926 çështja e marrëveshjeve të tjera do të pengohej akoma më shumë. Ato arritën të nënshkruheshin përfundimisht më 13 tetor 1926. Traktati i tregtisë dhe lundrimit do të rregullonte çështjet e tregtisë dhe të lundrimit dhe të dyja palët i jepnin njëra-tjetres trajtimin e kombit më të favorizuar. Problemet më të mëdha qëndronin me marrëveshjen e nënshtetësisë dhe të konsullores, e cila binte në kundërshtim me interesat greke dhe për këtë arsye megjithëse shteti shqiptar i ratifikoi këto marrëveshje, pala greke nuk e bëri ratifikimin.

## **KREU V**

### **MARRËDHËNIET E SHQIPËRISË ME TURQINË, RUMANINË DHE BULLGARINË NË VITET 1925-1928**

Kreu V trajton tendencat e shtetit shqiptar për të vendosur marrëdhënie në fushën e politikës së jashtme dhe me vende të tjera të Ballkanit, me Turqinë, Rumaninë dhe Bullgarinë. Në Ankara të Turqisë më 15 dhjetor 1923 midis shtetit shqiptar dhe atij turk u nënshkrua Traktati i Miqësisë, i cili shënoi dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis dy vendeve. Traktati përbëhej nga tre marrëveshje: marrëveshja diplomatike, marrëveshja konsullore dhe marrëveshja e nënshtetësisë. Ndërsa për dy marrëveshjet e para nuk pati përplasje midis dy palëve, mosmarrëveshjet filluan për marrëveshjen e tretë, atë të nënshtetësisë. Shqiptarëve në Turqi të pajisur me pasaporta shqiptare qeveria turke nuk u njohte as shtetësinë dhe as kombësinë. Në marrëveshjen me Turqinë pala shqiptare synonte mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në Turqi, duke mos u dëmtuar në çështjet e pasurisë dhe sidomos shpëtimi i myslimanëve nga shërbimi ushtarak dhe i të krishterëve nga këmbimi i detyrueshëm. Tërheqja e delegacioni shqiptar në kërkesat e tij në lidhje me marrëveshjen e nënshtetësisë bëri të mundur nënshkrimin e traktatit me Turqinë. Marrëveshja e nënshtetësisë i vuri shqiptarët në një pozitë më pak të favorshme sesa kombësitë e tjera. Marrëveshjet hynë në fuqi vetëm në vitin 1925, dhe një vit më pas, për të parën herë u hapën përfaqësitë në kryeqytetet përkatëse dhe u vendosën për herë të parë lidhjet diplomatike.

Në lidhje me marrëveshjen e shkëmbimit të popullsisë, e nënshkruar në Lozanë, qeveria turke për hir të interesave të saj ekonomike dhe demografike pranoi vendosjen e popullsisë

muslimane shqiptare në Turqi. Një problem tjetër ishte dhe ai i shqiptarëve ortodoksë në Turqi, të cilët ishin quajtur të pashkëmbyeshëm. Tendenca e qeverisë turke për t'i parë ata si grekë bëri të mundur që një pjesë e mirë e tyre të largohej dhe pasuria e tyre të konfiskohej. Në këtë kontekst dy çështje të pazgjidhura ishin: a) lirimi i pasurive të patundshme në Turqi, që i përkisnin shqiptarëve ortodoksë, të cilët ndodheshin në Shqipëri dhe b) vështirësitë që hasnin shqiptarët ortodoksë, të cilët kishin zgjedhur nënshtetësinë shqiptare, për tu larguar nga Turqia. Për t'i detyruar shqiptarët të zgjidhnin nënshtetësinë turke, qeveria turke përdori disa metoda: shqiptarët që kërkonin të merrnin nënshtetësinë shqiptare i përballi me formalitetet e zgjatura të pasaportave; kur ata kërkonin të shisnin pasuritë e tyre, i sorrollaste nëpër Zyrat e Kadastrave me qëllim që të lodheshin; atyre që kishin zgjedhur nënshtetësinë shqiptare u kishte dhënë vetëm një vit kohë për të shitur pasurinë etj. Pasi u vendosën, marrëdhëniet diplomatike nuk patën ndonjë avancim të mëtejshëm, për të shkuar më pas drejt ngrirjes së tyre me vendosjen e Mbretërisë Shqiptare.

Në një çështje më vete të këtij kreu pasqyrohen marrëdhëniet e shtetit shqiptar me atë rumun. Vendosja e lidhjeve favorizohej nga fakti se Rumania ishte vendi me ngulimet më të hershme dhe më aktive të shqiptarëve në diasporë dhe gjithashtu nga ky shtet në mesin e shekullit të 19-të, nga refugjatët shqiptarë në Bukuresht, me mbështetjen e shtetit rumun nisën përpjekjet e para të zgjimit të ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve për të krijuar një shtet të pavarur. Rumania ishte e para që kishte njohur Pavarësinë e Shqipërisë, duke dërguar më pas një përfaqësues të saj diplomatik në Durrës. Çështja e ekzistencës së minoriteteve shërbente si një urë lidhëse dhe përbënte dhe bazën e marrëdhënieve midis dy vendeve. Rumania në synimin e saj për t'u afruar me shtetin shqiptar nuk ka pasur interesa politike dhe ekonomike në dëm të Shqipërisë, qëllimi i saj ishte vetëm lidhja e marrëdhënieve miqësore. Marrëdhëniet diplomatike midis dy shteteve u vendosën në dhjetor të vitit 1924, kur Simeon Mandresku u caktua si ministër Fuqplotë i Rumanisë në Tiranë. Përfaqësuesi i parë diplomatik shqiptar në Rumani ishte Xhemil Dino. Rumania ishte një nga shtetet e para që njohu Republikën Shqiptare të shpallur në vitin 1925. Në periudhën midis dy luftërave shumë të rinj shqiptarë do të kryenin studimet në Rumani. Më 1 prill 1926 ministri rumun në Shqipëri u zëvendësua nga diplomati Jon Trandafilosku. Në gusht të vitit 1926 do të ndërrohet dhe përfaqësuesi shqiptar, ministri i ri Fuqplotë do të ishte Selaudin Blloshmi.

Në pjesën e fundit të kapitulli V shqyrtohet historia e marrëdhënieve diplomatike midis shtetit shqiptar dhe atij bullgar, duke u ndalur tek arsyet e mosvendosjes së një bashkëpunimi të mirëfilltë dhe problemet që shqetësonin të dyja palët. Ashtu si në Rumani, edhe në Bullgari ekzistonte një koloni e madhe dhe e hershme shqiptare, dhe gjithashtu dhe Bullgaria, si Rumania, ishte një nga shtetet e para që ka vendosur marrëdhënie zyrtare me Shqipërinë. Bullgaria kishte dërguar si drejtues të legatës së saj në Shqipëri që në vitin 1914 Todor Pavillovin. Marrëdhëniet diplomatike midis dy vendeve do të rivendoseshin në vitin 1922, kur si drejtues i legatës në Sofje u caktua Konstantin Boshnjaku. Të dyja shtetet në periudhën midis dy luftërave botërore kishin disa të përbashkëta, si: me përcaktimin e kufijve pas luftërave ishin në palën humbëse, jashtë kufijve të tyre mbetën territore të populluara me bashkëkombës, kishin pretendime territoriale ndaj Jugosllavisë dhe Greqisë dhe gjithashtu vareshin nga sjellja e shteteve të mëdha europiane. Në qershor 1924 Ivan Ikonov u caktua si përfaqësues diplomatik i Bullgarisë në Tiranë. Në vitin 1926 Shqipëria hapi legatën e saj në Sofje e drejtuar nga Rauf Fico, si ministër Fuqplotë. Marrëdhëniet midis dy palëve në këtë periudhë do të ndikoheshin si rezultat i dy çështjeve, të cilat ishin: a) çështja e pakicave shqiptare në Bullgari dhe e pakicave bullgare në Shqipëri, e cila nuk mori zgjidhje përfundimtare dhe b) lëvizja e elementit bullgar në Shqipëri.

## PËRFUNDIME

- Me rikthimin e Ahmet Zogut në pushtet, ai nuk humbi kohë për të bërë organizimin e vendit. Në të mirë të drejtimit me efikasitet, duke u mbështetur tek rrethanat e brendshme të shtetit shqiptar dhe mangësitë që ai shfaqte në shumë fusha por gjithashtu i nisur dhe nga rreziqet e jashtme, të cilat mund të cënonin konsolidimin e pozitës së shtetit shqiptar në sferën ndërkombëtare, Ahmet Zogu e përqëndroi pothuajse të gjithë pushtetin në duart e tij. Ai ndërmoi reforma rrënjësore në çdo hallkë të shtetit, të cilat do të ndihmonin për të minimizuar abuzimet në sektorë të ndryshëm të tij, do të hidhnin themelet për ngritjen e një shteti të fortë e të mbështetur tek ligjet dhe do të shërbenin për ta futur shtetin shqiptar në rrugën e zhvillimit. Gjithashtu Zogu bëri unifikimin e vendit dhe përhap influencën e ligjit në të gjithë territorin e shtetit shqiptar. U morën masa për të evituar rolin e ushtrisë në politikë, në mënyrë që të mos sillte probleme për stabilizimin e vendit dhe u bë organizimi i strukturave shtetërore sipas modeleve perëndimore, duke bërë një përshtatje të tyre me realitetin shqiptar të atyre viteve. Gjatë kësaj kohe u bë një punë e mirë për të luftuar problemet kryesore të vendit si: mosrespektimin e ligjit, kusarinë, gjakmarrjen dhe çarmatimin e popullsisë. Me vendosjen e një situatë politike të qëndrueshme përmes vendosjes së rendit dhe të qetësisë, do të ishte më e thjeshtë për të menduar për problemet financiare të vendit.
- Shqipëria, si një shtet që shfaqte probleme të theksuara në këtë kohë, kishte si nevojë primare ndihmën ekonomike të një shteti të huaj. Një sërë faktorësh ndikuan në afrimin e saj me Italinë dhe jo me Jugosllavinë, siç edhe pritej. Italia në përputhje me qëllimin që kishte, për ta kthyer Shqipërinë në një bazë për depërtimin e saj në Ballkan, përpunoi planin për rritjen e ndikimit të saj në sferën ekonomike dhe politike në Shqipëri. Zogu në këtë kohë arriti t'i shkëpupte Italisë një garanci kundrejt ndërhyrjes ushtarake jugosllave në Shqipëri, madje Italia i la atij të nënkuptonte se mund të jepte kontributin e saj në realizimin e bashkimit të rajoneve shqipfolëse me Shqipërinë. Për hir të interesave më të gjera që ndërthureshin në kontinent dhe jashtë tij, Italia mori aprovimin e munguar britanik që të vazhdonte më tej me planin e saj për depërtimin politik në Shqipëri. Izolimi ndërkombëtar, shpërthimi i kryengritjes së Dukagjinit dhe kriza e brendshme financiare e detyruan Zogun të hidhte firmën mbi Paktin e Parë të Tiranës më 27 nëntor 1926. Beogradi në bazë të traktatit italo-jugosllav të janarit 1924 pretendonte se Roma duhej t'a kishte pyetur më parë atë për këtë hap, gjë që Jugosllavia vetë nuk e kishte zbatuar kur ndërhyri për të rikthyer Ahmet Zogun në pushtet. Nga ngjarjet në vijim do të kuptohet se Italia nuk kishte si qëllim zbatimin e Paktit të Parë të Tiranës, pasi ajo bëri të njohur përgatitjet jugosllave për armatim gjatë kufirit shqiptar në muajin mars dhe ndërhyri për zgjidhjen në mënyrë paqësore të incidentit Gjurashkoviç. Nëse ky do të ishte qëllimi i saj, atëherë ajo duhet të kishte treguar indiferentizëm ndaj ngjarjeve të mësipërme. Përmes këtij pakti Shqipëria fitoi në politikën e jashtme një garanci dhe përkrahjen e Italisë në rast të një sulmi jugosllav.
- E pakënaqur nga rezultatet e Paktit të Parë të Tiranës, aq më tepër që Zogu u përpoq të çlirohej prej tij, Italia synonte në këtë kohë të rriste më tej ndikimin e saj politik në Shqipëri përmes nënshkrimit të një alence të re. Nga ana tjetër, Jugosllavia pas dështimit të përgatitjeve të saj ushtarake për sulmimin e kufirit shqiptar, dhe pas keqësimit të mëtejshëm të marrëdhënieve me Shqipërinë nga vrasja e Ceno bej Kryeziut më 14 tetor

1927, mendoi se ishte momenti të kundërpërgjigjej ndaj rritjes së ndikimit italian në Shqipëri, duke nënshkruar me Francën marrëveshjen e aleancës, të 11 nëntorit 1927. Ky traktat përveçse drejtohej kundër Italisë, përbënte gjithashtu dhe një rrezik potencial për Shqipërinë, duke qënë se përmes tij forcoheshin dukshëm pozitat e Jugosllavisë. Pasi Italia kishte përgatitur terrenin e jashtëm në mënyrë që aleanca e re të mos haste në kundërshtime, kjo ngjarje ishte nxitja e duhur për Mussolini-n që të shpejtonte nënshkrimin e Paktin të Dytë të Tiranës me shtetin shqiptar më 22 nëntor 1927. Pakti në fjalë synonte që Italia dhe Shqipëria, bashkarisht të përpiqeshin të gjenin një zgjidhje paqësore kundrejt kërcënimeve të një shteti të tretë ndaj tyre dhe nëse kjo zgjidhje nuk do të ishte e mundur, atëherë ato detyroheshin të bashkoheshin në luftë. Pra, ky pakt kishte si qëllim mbrojtjen dhe jo kundërsulmimin. Marrëveshja përfaqësonte një element në favor të sigurimit të pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të Shqipërisë, i cili ishte i ndryshëm nga garancia që mundësonte Lidhja e Kombeve.

- Mosekzistenca e një banke kombëtare e pengonte zhvillimin e shtetit shqiptar në rrugën e ekonomisë kapitaliste të tregut, në të cilën ai kishte hedhur hapat e parë. Zgjidhja për kohën ishte krijimi i Bankës Kombëtare dhe dhënia e saj me koncesion një fuqie të huaj. Koncesioni iu dha shtetit italian. Megjithatë, për të bërë balancimin e ndikimit italian në këtë fushë, u ndërморën dhe hapa për të tërhequr në Shqipëri kapitalin e shteteve fqinje, megjithëse ato nuk kishin fuqinë e duhur për të konkurruar kapitalin italian. Rëndësia e krijimit të bankës për shtetin shqiptar ishte shumë e madhe, duke marrë parasysh gjendjen e prapambetur në sistemin financiar që ai trashëgonte. Banka luajti një rol të pazëvendësueshëm në nxitjen që i dha zhvillimit kapitalist në ekonomi, por njëkohësisht ajo i shërbeu Italisë për të kontrolluar financat shqiptare dhe për të rritur më tej presionet ndaj Zogut. Pavarësisht kësaj, nga banka pritshmëritë ishin të larta, por faktorët kompleksë që vepruan në vitet 20-30 të shekullit të kaluar nuk mund të lejonin ndryshime më të mëdha në kapërcimin e nivelit shumë të prapambetur të trashëguar në prag të Shpalljes së Pavarësisë në vitin 1912 dhe riparimin e dëmeve të mëdha të shkaktuara nga luftërat që pasuan në vitet 1912-1918. Por, gjithsesi ato lejuan të ecej përpara dhe të zbutej prapambetja. Zhvillimet e reja do të ishin të pakthyeshme në të ardhmen.
- Nisur nga gjendja aspak e mirë ekonomike dhe shoqërore e popullsisë shqiptare në këto vite, e cila shfaqej në të gjitha sferat, lindi nevoja e marrjes së një borxhi, për të cilin u nënshkrua një marrëveshje njëkohësisht me krijimin e Bankës Kombëtare Shqiptare. Huaja u dha nga vetë shteti italian. Ndonëse fillimisht pjesa më e madhe e të ardhurave u përcaktua se do të shkonte për bujqësinë, duke marrë parasysh premiset që ajo shfaqte, pasi në eksportin shqiptar mbizotëronin prodhimet bujqësore, nuk ndodhi kështu. Shqipëria në këtë kohë ishte më shumë e interesuar për ndërtimin e rrugëve dhe urave, të cilat do të lidhnin zonat e ndryshme ekonomike në një treg unik. Përparimi i vendit nuk mund të arrihej pa një sistem komunikacioni bashkëkohor. Ky qëllim i saj u përputh njëkohësisht dhe me interesat italiane në Shqipëri. Huaja SVEA luajti një rol me rëndësi në vënien e ekonomisë së Shqipërisë në rrugën e zhvillimit dhe ndihmoi që ekonomia të hidhte disa hapa përpara. Përmes saj u ndërtua një sistem rrugësh e urash sipas standarteve të kohës. Pavarësisht se buxheti i shtetit u stabilizua disi, nevojat e ekonomisë ishin ende të mëdha dhe të ardhurat e këtij buxheti ishin të pamjaftueshme për shpenzimet e mbajtjes së shtetit.

- Ahmet Zogu, i bindur se ekonomia shqiptare mund të zhvillohej vetëm përmes investimeve të kapitalit të huaj dhe duke qënë se pritshmëritë në fushën e naftës dukeshin tepër të larta, do përpiqet të shfrytëzojë me shumë mjeshtëri nxitjen e interesit të shteteve të ndryshme për të bërë investime në Shqipëri, sidomos në këtë fushë. Nafta shqiptare do të bëhej një “mollë shërri” në marrëdhëniet midis Britanisë së Madhe dhe Italisë, dy shteteve më të interesuara për këtë koncesion. Ndërsa qëllimet e kërkesës së anglezëve ishin tregtare, ato italiane ishin më shumë politike, kjo dhe nga fakti se italianët ngulmonin për këtë koncesion dhe synonin të derdhnin shuma të mëdha parash, pa qënë të sigurtë nëse investimet për të do ia vlenin. Ahmet Zogu duke qënë shumë i vogël dhe i pafuqishëm për të zgjidhur konfliktin midis Britanisë së Madhe dhe Italisë, një zënkë që zhvillohej midis dy shteteve me potenciale të mëdha dhe gjithashtu në një moment kur në Europë përplaseshin interesa të shumta dhe të fuqishme, u detyrua të pranonte zgjidhjen që britanikët i dhanë problemit. Britania e Madhe pavarësisht se arriti që koncesioni i saj të ratifikohet, më vonë ajo do të tërhiqet nga kjo “luftë” me Italinë, duke arritur një kompromis me të, gjë që i hapi rrugë kapitalit italian në Shqipëri. Duke vendosur në peshore fitimet që ajo do të kishte nga kjo veprimtari në Shqipëri dhe marrëdhëniet e mira me Italinë, ajo u detyrua të zgjidhte të dytën, me nevojën për ta mbajtur Italinë në anën e saj, duke qënë së Italia do t’i shërbente më së miri asaj për të balancuar influencën franceze në kontinent. Pas arritjes së gjuhës së përbashkët midis tyre, përveç shoqërive angleze dhe italiane, në Shqipëri morën koncesione dhe shoqëritë amerikane dhe franceze.
- Shteti italian u tregua më i vendosur në lidhje me koncesionet e naftës në Shqipëri. Kështu, shoqëria që pati një veprimtari më të gjërë në kërkimin dhe shfrytëzimin e naftës në territorin shqiptar ishte shoqëria italiane AIPA. Kërkimet e saj fillimisht hasën vështirësi në lidhje me evidentimin e shtresave të naftës. Në kuadër të aktivitetit të saj dhe që ndikuan pozitivisht dhe për shtetin shqiptar ishin studimet që u bënë nga inxhinierë të ndryshëm të saj mbi ndërtimin strukturor të vendit, njohjen e tektonikës etj. Në ndryshim nga vitet e para, në vitin 1927 aktiviteti i saj filloi të rritet, duke u shoqëruar dhe me rezulate më të kënaqshme. Qëllimi i shtetit italian përmes kësaj shoqërie ishte të vendoste monopolin mbi vajgurin shqiptar. Territori që rezultoi të ishte shumë i pasur me naftë ishte zona e Beratit (Kuçova), në të cilën në vitet në vijim do të përqëndrohet pjesa dërrmuese e veprimtarisë së AIPA-s. Gjithsesi, si rezultat i faktit që Shqipëria ishte një zonë me tektonikë intensive, nivelet e rezervave të naftës ishin shpërndarë në një mënyrë të pabarabartë. Kështu AIPA nuk arriti sukseset që priste. Koncesionet që iu dhanë kompanive të huaja gjatë kësaj kohe nuk patën atë ndikim që pritej të kishin në zhvillimin e ekonomisë shqiptare, kjo si rezultat i moszbatimit prej tyre të pikave të marrëveshjes.
- Në vitin 1913 Konferenca e Ambasadorëve nuk kishte bërë një përcaktim të qartë për Shën Naumin, nëse duhej të përfshihej brenda territorit shqiptar apo jo. Kështu lindi nevoja e saktësimit të këtij vendimi. Bashkë me Shën Naumin shteti jugosllav ndoqi dhe çështjen e kufirit në Vermosh. Për zgjidhjen e çështjes u hodh ideja e kompensimeve territoriale. Në lëshimin e Shën Naumit pjesën më të madhe të përgjegjësisë e kishte Konferenca e Ambasadorëve, e cila megjithëse për të disatën herë vendosi në favor të

Shqipërisë, ajo nuk u tregua e gatshme t'a detyronte Jugosllavinë të lironte territorin e manastirit, të cilin e mbante të pushtuar që nga viti 1912 dhe të zbatonte vendimet e saj. Me rritjen e presionit jugosllav, i cili mbështetej fuqishëm nga Franca, Konferenca e Ambasadorëve do të shfaqë një tërheqje të saj, duke dhënë një vendim jo plotësisht të qartë në prill të vitit 1925. Vendimi i marrë enkas, e ndihmoi atë për të ushtruar presion që pala shqiptare dhe ajo jugosllave të hynin në bisedime, duke treguar dhe paaftësinë e saj për të detyruar jugosllavët të zbatonin vendimin e marrë, për shkak të përçarjes që ekzistonte ndër Fuqitë e Mëdha si pasojë e kundërshtimit francez. Nga ana tjetër ky vendim shpëtoi reputacionin e Konferencës së Ambasadorëve, i cili do të rrezikohej së tepërmi nëse ai do të ndryshohej. Moscaktimi i kufijve mund t'i shkaktonte probleme shtetit shqiptar për shkak të elementeve, të cilët ishin të prirur për të shkaktuar turbullira. Zogu e realizoi shkëmbimin e territoreve në mënyrë që të mos kishte probleme me Jugosllavinë dhe të fokusohet më pas në stabilizimin e Shqipërisë si shtet i pavarur.

- Edhe pse që në fillim të vitit 1925 Jugosllavia kishte njohur përparësinë e interesave ekonomike italiane në Shqipëri, ajo do të përpiqet për t'a ndryshuar situatën në favor të saj, në mos për të mbizotëruar në fushën e koncesioneve ekonomike, të paktën për të patur një ndikim të barabartë me kapitalin italian. Por kjo gjë nuk ndodhi as me planin e saj për krijimin e bankës serbo-shqiptare dhe as kur u krijua Banka Kombëtare e Shqipërisë. Në shenjë të respektimit të marrëveshjeve të përbashkëta italo-jugosllave për një ndërhyrje të bashkërenduar në Shqipëri, në Bankën Kombëtare Shqiptare palës jugosllave iu dha një përqindje shumë e vogël aksionesh, thjeshtë sa për të justifikuar pjesëmarrjen e tyre dhe për mos t'i lënë duarbosh në këtë veprimtari. Me krijimin e Bankës Kombëtare Shqiptare, filiali i Shkodrës i Bankës Serbo-Shqiptare u la plotësisht në hije. Dështimi i kapitalit jugosllav përballë atij italian u pa jo vetëm në fushën e bankës por edhe në çdo fushë tjetër ku jugosllavët kërkuan të marrin koncesione. Për të arritur qëllimet e saj politike Jugosllavia fillimisht tentoi të përdorte si rrugë lënien pas dore të rregullimit të marrëdhënieve ekonomike me shtetin shqiptar, por kur ky hap u bë nga Italia, atëherë dhe ajo ndryshoi kursin e asaj në këtë drejtim.
- Pas humbjeve të njëpasnjëshme përballë kapitalit italian në marrjen e koncesioneve ekonomike në Shqipëri, Jugosllavia mendonte se ajo do të ishte gjithmonë pala e humbur në këtë "luftë", sidomos për aq kohë sa në pushtet do të qëndronte Ahmet Zogu. Për këtë arsye ajo do të kërkojë një rrugëzgjdhje tjetër, duke hedhur sytë nga emigracioni politik, të cilin në rastin më të keq do t'a përdorte për të zëvendësuar regjimin, ndërsa në rastin më të mirë si një element përmes të cilit do rriste presionin në favor të synimeve të saj. Jugosllavia dhe Italia financonin rregullisht emigrantët politikë, në mënyrë që t'i përdornin nëse do të lindte nevoja në të ardhmen. Ndërsa qeveria shqiptare ishte në bisedime me qeverinë italiane për nënshkrimin e Paktit të Parë të Tiranës, në këtë kohë shpërtheu kryengritja e Dukagjinit, kërcënimi i parë i një niveli serioz për qeverinë shqiptare. Në mënyrë që të frikësonte Zogun, meqënëse ai nuk favorizoi depërtimin jugosllav në Shqipëri, Jugosllavia nxiti këtë kryengritje duke shfrytëzuar pakënaqësinë e banorëve të zonave veriore të vendit në lidhje me taksat, me masat e rrepta të xhandarmërisë për mbledhjen e tyre, me shërbimin ushtarak dhe çarmatosjen e popullsisë. Ndërkohë, kryengritja dha efektin e kundërt që kishte shpresuar Jugosllavia, atë të afrimit të mëtejshëm të Zogut me Italinë, pasi Italia e cila ishte e informuar rreth

organizimit të kësaj kryengritjeje, e shfrytëzoi mirë situatën e vështirë në të cilën u gjend vendi për t'i imponuar Zogut nënshkrimin e Paktit të Parë të Tiranës.

- Pas nënshkrimit të Paktit të Parë të Tiranës në qarqet politike jugosllave lindi ideja se Zogu duhej zëvendësuar me një element nga radhët e emigracionit politik shqiptar, i cili do të punonte për të favorizuar interesat jugosllave. Përgatitjet ushtarake jugosllave morën një karakter shumë serioz. Denoncimi italian i përgatitjeve jugosllave i shërbeu mbrojtjes së regjimit shqiptar dhe gjithashtu ai ishte arsyeja se përse Jugosllavia nuk e realizoi dot qëllimin e saj. Ndërkohë, dështimi i politikës jugosllave në Shqipëri dhe njëkohësisht përkeqësimi i marrëdhënieve midis dy vendeve do të vulosej nga dy ngjarje: incidenti i Gjurashkoviçit dhe vrasja e Ceno bej Kryeziut. Në ngjarjen e parë Jugosllavia nuk harroi të tregonte prepotencën e saj në marrëdhëniet me qeverinë shqiptare, ndërsa e dyta u cilësua si një lloj hakmarrjeje për faktin se Ceno ishte një agjent jugosllav dhe një element që i shërbente fuqishëm forcimit të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, duke rrezikuar në këtë mënyrë pozitën e interesave italiane në Shqipëri.
- Greqia fushatën e saj për spastrimin e popullsisë myslimane shqiptare nga territoret që ajo kishte pushtuar do ta mbështesë tek përdorimi i gënjeshtreve, shtrembërimi i së vërtetës, influencimi mbi organet ndërkombëtare, shfrytëzimi i përkrahjes që i jepnin Fuqitë e Mëdha etj. Vetëm me rikthimin e Ahmet Zogut në pushtet ndryshoi pozitivisht qëndrimi i shtetit grek ndaj popullsisë çame, e shoqëruar me përmirësimin e marrëdhënieve shqiptaro-greke. Ky ndryshim i qëndrimit u diktua nga problemet e brendshme dhe të jashtme të shtetit grek, por sidomos nga faktori ndërkombëtar. Qeveria shqiptare me të gjitha forcat e saj protestoi shumë herë pranë Lidhjes së Kombeve për politikën që po ndiqte qeveria greke ndaj popullsisë myslimane shqiptare, por protestat e saj të gjitha herët nuk patën vëmendjen e duhur, pasi vinin nga një shtet i vogël dhe i pafuqishëm. Fuqitë e Mëdha në mënyrë të heshtur lejuan qeverinë greke të vazhdonte planin e saj të spastrimit etnik. Lidhja e Kombeve dhe organizmat e saj bënë një punë të përciptë për këtë çështje dhe e trajtuan në mënyrë të njëanshme problemin e minoriteteve. Kjo dukej dhe në zgjidhjen që Lidhja e Kombeve i dha në qershor të vitit 1928 dy çështjeve kryesore që shqetësonin marrëdhëniet shqiptaro-greke, çështjes së pasurive të shqiptarëve në Greqi dhe çështjes së minoritetit shqiptar në këtë shtet..
- Një hap pozitiv në marrëdhëniet shqiptaro-greke do të ishte nënshkrimi i disa marrëveshjeve midis dy vendeve, përmes të cilave ndër të tjera qeveria shqiptare do të synonte të zgjidhte dhe çështjet e mbetura pezull midis dy shteteve. Traktatet kishin shumë rëndësi sidomos për palën shqiptare, duke qënë se fqinja e saj nuk ishte e prirur për marrëdhënie të mira me shtetin shqiptar. Pas shumë përpjekjesh traktatet u nënshkruan dhe përmes ratifikimit të tyre shteti shqiptar tregoi përsëri se ishte i gatshëm për të mbajtur raporte të mira me shtetin grek, pavarësisht qëndrimeve të tij deri në këtë kohë. Qeveria shqiptare hasi vështirësi në ratifikimin e tyre nga parlamenti grek. Kjo sepse marrëveshja e nënshtetësisë binte ndesh me politikën që qeveria greke po ndiqte ndaj popullsisë myslimane shqiptare dhe me kundërshtimin e saj të vendosur për të dëmshpërblyer pronat e saj. Kështu që shteti grek nuk do të ishte dakord që për të përmirësuar marrëdhëniet shqiptaro-greke të paguante një çmim kaq të lartë.

- Shqipëria si një shtet i ri kishte nevojë të afirmohej dhe të vendoste marrëdhënie me shtete të ndryshme të rajonit, sidomos kur flitej për një vend me të cilin kishte bashkëjetuar pesë shekuj. Nga ana tjetër Turqia, duke e parë veten në pozicionin e një elementi stabilizues midis Lindjes dhe Perëndimit, i shihte dhe ajo të domosdoshme marrëdhëniet e mira dhe me shtetet ballkanike. Problemi që shqetësonte qeverinë shqiptare në lidhje me vështirësitë e emigrantëve në Turqi, mosnjohja nga autoritetet turke e nënshtetësisë, pasaportave dhe e dokumenteve të tjera të lëshuara nga administrata shqiptare mori në këtë periudhë një zgjidhje të pjesshme. Kjo në sajë të nënshkrimit të marrëveshjes së nënshtetësisë midis Shqipërisë dhe Turqisë. Por njohja e qeverisë turke për pasaportat shqiptare ishte vetëm për shqiptarët që kishin qënë në Shqipëri kur ishte krijuar shteti shqiptar më 28 nëntor 1912. Për shkak të synimeve të politikës turke në këtë kohë, marrëdhëniet me shtetin shqiptar nuk patën ndonjë zhvillim tjetër të rëndësishëm.
  
- Në marrëdhëniet me shtetin rumun shteti shqiptar nisej nga pozitat e një shteti mirënjohës, duke qënë se atje ekzistonte kolonia më e hershme shqiptare. Që me shpalljen e Pavarësisë së shtetit shqiptar Rumania do të mbante një qëndrim pozitiv ndaj tij. Në marrëdhëniet midis dy vendeve çështja kryesore për t'u diskutuar ishte ajo e minoriteteve në të dyja shtetet dhe e të drejtave të tyre. Gjatë këtyre viteve shprehet dëshira e mirë e të dyja palëve për të patur marrëdhënie sa më të ngushta jo vetëm në sferën politike, por edhe në atë kulturore dhe ekonomike. Pavarësisht vullnetit të mirë, këto shtete nuk arritën dot të vendosnin një bashkëpunim real, gjë që u shoqërua me mbajtjen e marrëdhënieve diplomatike midis tyre vetëm në nivel zyrtar.
  
- Në këto vite shteti shqiptar bëri përpjekje për të pasur marrëdhënie dhe me shtetin bullgar, në të cilin kishte një koloni shqiptare, e cila ishte përshtatur mirë, kjo në sajë dhe të përkrahjes që ajo gjeti në këtë shtet. Shqipëria, si një shtet më i vogël, që kishte më tepër nevojë për përkrahje dhe i interesuar për vendosjen e marrëdhënieve të mira me sa më shumë vende, marrëdhëniet me Bullgarinë i ka ndjekur dhe i ka shqyrtuar me më shumë vendosmëri se qeveria bullgare. Fatkeqësisht, si rezultat i fokusimit tek problemet e brendshme që kishin, të cilat ishin të një niveli serioz, sidomos për Shqipërinë, por gjithashtu dhe nga fakti se gjendeshin në një situatë të disfavorshme në politikën e jashtme, si shteti shqiptar ashtu dhe ai bullgar nuk ndodheshin në një pozicion komod për të krijuar klimën e duhur për një ndërveprim të ngushtë midis tyre. Si rrjedhojë, marrëdhëniet diplomatike midis dy vendeve ishin shumë të cinguara.

## BIBLIOGRAFIA

### I. BURIME ARKIVORE VENDASE

#### 1. AQSH (Arkivi Qendror Shtetëror)

Fondi Nr. 146, 246 (Parlamenti)  
Fondi Nr. 149, 249 (Kryeministria)  
Fondi Nr. 151, 251 (Ministria e Punëve të Jashtme)  
Fondi Nr. 152, 252 (Ministria e Punëve të Brendshme)  
Fondi Nr. 155 (Ministria e Drejtësisë)  
Fondi Nr. 163, 263 (Legata italiane)  
Fondi Nr. 177 (Ministria e Punëve Botore)  
Fondi Nr. 178 (Ministria e Financave)  
Fondi Nr. 179 (Banka Kombëtare e Shqipërisë)  
Fondi Nr. 195 (Ministria e Arsimit)  
Fondi Nr. 202 (Drejtoria e Përgjithshme e Shëndetësisë)  
Fondi Nr. 235 (Prefektura e Durrësit)  
Fondi Nr. 268 (Legata jugosllave)  
Fondi Nr. 271 (Prefektura e Elbasanit)  
Fondi Nr. 342 (Prefektura e Kosovës (Kukësit))  
Fondi Nr. 380 (Bashkia Tiranë)

#### 2. AMPJ (Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme)

Fondi 151, vitet 1925-1928

#### 3. AIH (Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë)

A-V Historia moderne 1918-1944

### II. BURIME ARKIVORE TË HUAJA

*Arhiv Vojno-Istorijskog Instituta*, Beograd.

*Diplomatski Arhiv Saveznog Sekretariata Inostranij Poslova*, Beograd.

*League of Nations, Treaty Series*, vol. LX, Geneve: 1927.

*The National Archives*, London.

### III. BOTIME DOKUMENTARE

#### 1. Botime dokumentare vendase

*Dokumente për Çamërinë 1912-1939*, përgatitur nga Kaliopi Naska, botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, Tiranë: Dituria, 1999.

*Marrëdhëniet sovjetike-shqiptare në vitet 20 dhe 30 të shekullit XX*, përgatitur nga Lenina Zhila dhe Vlado Popovski, Tetovë: 2012.

*Mid'hat Frashëri. Ministër Fuqiptotë në Athinë (1923-1926)*, përgatitur nga Luan Malltezi dhe Sherif Delvina, Tiranë: Lumo Skëndo, 2002.

*Shën Naumi dhe diplomacia e kohës*, përgatiti për botim Kaliopi Naska, Tiranë: Kristalina-KH, 2012.

*Shqipëria më 1937. Veprimi shtetnor gjatë njëzet e pesë vjeteve të parë të vetqeverimit*, vëll. II, Tiranë: Shtypshkronja Kristo Luarasi, 1938.

## **2. Botime dokumentare të huaja**

*Documenti Diplomatici Italiani*, Settima serie (1922-1935), vol. III (23 febbraio 1924-14 maggio 1925), Roma: La libreria dello Stato, 1959.

*Documenti Diplomatici Italiani*, Settima serie (1922-1935), vol. IV (15 maggio 1925-6 febbraio 1927), Roma: La libreria dello Stato, 1962.

*Documenti Diplomatici Italiani*, Settima serie (1922-1935), vol. V (7 febbraio-31 dicembre 1927), Roma: La libreria dello Stato, 1967.

*Documenti Diplomatici Italiani*, Settima serie (1922-1935), vol. VI (1 gennaio – 23 settembre 1928), a cura di G. Carocci, Roma: Istituto Poligrafico dello Stato, 1967.

*Documents on British Foreign Policy (1919-1939)*, First Series, vol. XXVI, London: Her Majesty's Stationery Office, 1985.

*Documents on British Foreign Policy*, First Series, vol. XXVII, Edited by W. Medlicott and Douglas Dakin, London: HMSO, 1984-1986.

*Documents on British Foreign Policy (1919-1939)*, Series IA, vol. II, The termination of military control in Germany, Middle Eastern and American questions, 1926-1927, Edited by William Norton Medlicott etc., London: 1968.

*Documents on British Foreign Policy (1919-1939)*, Series IA, vol. IV, European and security questions, (1927-1928), Edited by William Norton Medlicott [et al.], London: HMSO, 1971.

*Foreign Relations of United States of America*, 1925, vol. I, Washington: Joseph V. Fuller, 1940.

*Türkiye Büyük Millet Meclisi K.M, III.Cilt*, Ankara: 1928.

*Türkiye Büyük Millet Meclisi K.M, ikinci devre c.I*, Ankara: 1942.

*The Cham Albanians of Greece. A Documentary History*, edited by Robert Elsie and Bejtullah Destani, In association with The Centre for Albanian Studies, London: I. B. TAURIS, 2012.

*Un Decennio di vita della SVEA*, Roma: Libreria dello Stato, 1936.

*Verbale della assemblea di costituzione: Roma, 2 Settembre 1925: con il discorso inaugurale pronunciato dal presidente Mario Alberti*, Roma: 1925.

## **IV. GAZETA DHE REVISTA**

*Afrimi*, Vlorë, 1926

*Albania*, Romë, 1943

*Albania News*, Romë, 2012

*Albanica*, 2010

*Besa*, Tiranë, 1933

*Bisedimet*, Kajro, 1925

*Bisedimet e Kuvendit Kushtetues*, Tiranë, 1925

*Demokratia*, Gjirokastër, 1926, 1927, 1928

*Dielli*, Boston Mass., 1925, 1927

*Drita*, Gjirokastër, 1923

*E drejta*, Stamboll, 1924

*Ekonomia Popullore*, Tiranë, 1965

*Fletorja Zyrtare*, Tiranë, 1925, 1926

*Foreign Affairs*, 1926

*Gazeta e Korçës*, Korçë, 1924,1925,1926  
*Gazeta Shqiptare*, Bari, 1927, 1928  
*Indipendenca Shqiptare*, Tiranë, 1925  
*I petroli dell'Albania*, Romë, 1942  
*La rivista italiana del petrolio*, Romë, 1937  
*L'Industria ed il Commercio Italo-Albanese*, Milano, 1928  
*Liria Kombëtare*, Kostancë, 1934  
*Lirija Kombëtare*, Gjenevë, 1925, 1926  
*Novosti*, Beograd, 1927  
*Politika*, Beograd, 1925,1927  
*Probleme Ekonomike*, Tiranë, 1975  
*Proia*, 1928  
*Shekulli i Ri*, Durrës, 1928  
*Shqipëri e Re*, Kostancë, 1926,1927, 1928  
*Shqipnija*, 1926  
*Telegraf*, Tiranë 1927  
*Zani i popullit*, 1926  
*Zëri i Korçës*, Korçë, 1927

## V. LITERATURA HISTORIOGRAFIKE

Academie des Sciences Sociales et Politiques .Institut D' Etudes Sud-Est Europeennes, *Revue des etudes Sud-Est Europeennes, Tome XIX,N°1*(Janvier-Mars), Bucarest: Editura Academiei Republicii Socialiste Romania, 1981.

Ahmad, Feroz - *Qemal Ataturku dhe themelimi i Turqisë moderne*, Tiranë: AIIS, 2010.

Alban, Nexhip P. - *Shqiptarët në Perandorinë Osmane*, Tiranë: Albin, 1997.

Anastasi, Aurela - *Institucionet politike dhe e drejta kushtetuese në Shqipëri (1912-1939)*, Tiranë: Luarasi, 1998.

*Anuari i realizimit të planit për gjithë sektorët e ekonomisë popullore për vitin 1949.*

Arifi-Bakalli, Emine - “Qëndrimi i Fuqive të Mëdha ndaj konfliktit italo-jugosllav në mars të vitit 1927”, në *Gjurmime Albanologjike*, nr. 20, Prishtinë: 1990.

Armstrong, Heaton - *Ujku i murrmë. Jeta dhe vepra e Mustafa Qemal Ataturkut*, Tiranë: Konica Color, 2008.

Artisien, Patrick - *Albania*, New York: Armonk, 1986.

Asllani, Uran - *Diplomacia dhe diplomatët shqiptarë 1912-1944*, Tiranë : ILAR, 2006.

Austin, Robert C. - *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit : (demokracia shqiptare në vitet 1920-1924)*, Tiranë : Albin, 2003.

Avramovski, Živko - “Kontributi i studimit të historisë së Shqipërisë në periudhën midis dy luftërave botërore”, në *Gjurmime albanologjike*, nr. 2, Prishtinë: 1968.

Avramovski, Živko - *Britanci o Kraljevini Jugoslaviji*, Knjiga Prva (1921-1930), Arhiv Jugoslavije, Zagreb: Globus, 1986.

Baldacci, Antonio - *L'Albania, 1930. Studi speciali albanesi*, Roma: Anonima Roma Editoriale, 1932.

Baldacci, Antonio - *Shqipëria e Madhe*, Tiranë: UEGEN, 2006.

Bartl, Peter - *Shqiptarët (nga mesjeta deri në ditët tona)*, Tiranë: Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, 1995.

- Bashkurti, Lisen - *Diplomacia shqiptare (vëll.I)*, Tiranë: GEER, 2005.
- Belegu, Mentar - “Politika zogiste e dyerve të hapura në v.1925-1926”, *Studime historike*, Tiranë: Mihal Duri, 1964.
- Bello, Hasan - *Marrëdhëniet shqiptaro-turke (1912-1939)*”, Tiranë: Kristalina-KH, 2015.
- Bernstein, Herman & Grant, Hugh G. - *2 diplomatë amerikanë për mbretin Zog*, Tiranë: DARDANIA, 1994.
- Biagini, Antonello - *Historia e Shqipërisë nga zanafilla deri në ditët tona*, Tiranë: SHTËPIA E LIBRIT DHE E KOMUNIKIMIT, 2000.
- Bobev, Bobi - “Bullgaria dhe Shqipëria nga shpallja e pavarësisë deri në fillimin e luftës së dytë botërore 1912-1939”, *100 Vjet Pavarësi, Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare, vëll II*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë :Botimet Albanologjike, 2014.
- Borgogni, Massimo - *Tra continuita e incertezza. Italia e Albania (1914-1939)*, Milano: Franco Angeli, 2007.
- Bubani, Dionis - *Historia e Rumanisë*, Tiranë: Toena 2001.
- Buda, Aleks - *Shkrime historike vëll.2*, Tiranë, 1986.
- Calmes, Albert - *Report on the economic and financial situation in Albania*, League of Nations, Geneva: 1922.
- Canal, Zekeria - *Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar 1912-1913*, Prishtinë: +, 1996.
- Carocci, Giampiero - *La politica esterna dell'Italia fascista 1925-1928*, Bari: Laterza, 1969.
- Cassels, Alan - *Mussolini's Early Diplomacy*, Princeton: Princeton University Press, 1970.
- Castellan, Georges - *Historia e Ballkanit, shek XIV-XX*, Tiranë : CABEJ, 1996.
- Cici, Arben - *Marrëdhëniet shqiptaro-italiane në vitet 1920-1934*, Tiranë: AFËRDITA, 2002.
- Costa, Nicolas J. - *Shqipëria: Enigmë evropiane*, Tiranë: Omsca-1, 2002.
- Culaj, Lush - *Shqiptarët në gjysmën e parë të shekullit XX*, Prishtinë: KGT, 2005.
- Culaj, Lush - *Shqipëria dhe problemi kombëtar 1918-1928*, Prishtinë: Drini Graf-Klinë, 2004.
- Çami, Muin - *Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare (1914-1918)*, Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1987.
- Çami, Muin - *Shqipëria në rrjedhat e historisë ( 1912-1924)*, Tiranë, Onufri, 2007.
- Çollaku, Thimi - *Shqipëria palë në traktatet ndërkombëtare*, Tiranë: ASD, 2013.
- Dako, Kristo - *Shënime historike nga jeta dhe veprat e Nalt Madhërisë së tij Zogu i Parë, Mbreti i Shqiptarëve*, Tiranë: KRISTO LUARASI, 1937.
- Damiani, Enrico; Salvini, Luigi; Grazia, Guido & Mavrodinov, Nikola - *Bullgaria*, Roma: Edizioni Roma, 1939.
- De Felice, Renzo - *Historia e shkurtër e fashizmit*, Tiranë: Dituria, 2005.
- Demi, Petrit - *E vërteta në marrëdhëniet greko-shqiptare*, Tiranë: Argeta-LMG, 2002.
- Dervishi, Kastriot - *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005*, Tiranë: 55, 2006.
- Dervishi, Kastriot - *Njohja në parim e shtetit shqiptar : 1912/ Konferenca e Ambasadorëve në Londër*, Tiranë: 55, 2012.
- Dragoj, Nuri - *Shqiptarët dhe grekët*, Tiranë: Weso, 2009.
- Duka, Valentina - *Çështje të historisë bashkëkohore të shqiptarëve*, Tiranë: SHBLU, 2003.
- Duka, Valentina - *Historia e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë:SHBLU, 2007.
- Duka, Valentina - *Shqiptarët në rrjedhat e shek XX*, Tiranë: SHBLU, 2003.
- Ermenji, Abaz - *Vendi që zë Skënderbeu në historinë e Shqipërisë*, Tiranë: Çabej, 1996.
- Fevziu, Blendi - *100 vjet pavarësi, një ekskursion në politikën e shtetit shqiptar nga 1912-2012*, Tiranë: UET Press, 2012.
- Fiçorri, Ramiz - *Ndërrhyrja italiane në Shqipëri (1925-1939)*, Tiranë: KOÇI, 2005.

Fischer, Bernd J. - *Ahmet Zogu, Mbreti shqiptar midis dy luftave*, Tiranë: AIIS, 2009.

Fisher, Bernd J. - *Diktatorët e Ballkanit*, Tiranë: AIIS; 2009.

Fischer, Bernd J. - *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë: Çabej, 2004.

Fishta, Iljaz - "Lufta e Fuqive të Mëdha imperialiste për zotërimin e vendburimeve vajguore, politika kapitulluese e regjimit të Ahmet Zogut në këtë fushë, pasojat e saj skllavëruese për Shqipërinë (1925-1939)", *Buletin shkencor*, Nr.2. Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, Shkodër: Migjeni, 1972.

Fishta, Iljaz - *Ndërhyrja e kapitalit të huaj dhe pasojat e saj skllavëruese për Shqipërinë (1925-1931)*, Tiranë: Mihal Duri, 1979.

Fishta, Iljaz - *Sistemi monetar dhe i kreditit në Shqipëri (1925-1944)*, Tiranë: Mihal Duri, 1971.

Fishta, Iljaz & Toçi, Veniamin - "Gjendja ekonomike e Shqipërisë në vitet 1912-1944, prapambetja e saj, shkaqet dhe pasojat", *Studime historike*, Nr.2, Viron Koka, Tiranë: Mihal Duri, 1984.

Fishta, Iljaz & Kareco, Theodor - *Prona private në Shqipëri 1924-1944*, Tiranë: Dituria, 1996.

Frashëri, Mehdi - *Kujtime (1913-1933)*, Tiranë: OMSCA, 2005.

Frashëri, Mehdi - *Problemet shqiptare*, Tiranë: Plejad, 2016.

Frashëri, Tanush - *Ali Këlcyra, aristokrati kuq e zi*, Tiranë: Çabej, 2005.

Giannini, Amedeo - *La formazione dell'Albania*, Roma: ANONIMA ROMANA EDITORIALE, 1930.

Giannini, Amedeo - *L'Albania dall'indipendenza all'unione con l'Italia (1913-1939)*, Varese: Istituto per gli Studi di politica Internazionale, 1940.

Glenny, Misha - *Histori e Ballkanit 1804-1999*, Tiranë: TOENA, 2007.

Gogaj, Iljaz - *Arsimi shqip në diasporë dhe në Çamëri (1912-1944)*, Tiranë: Naim Frashëri, 2007.

Hamiti, Zenel - *Historiku i vajgurit në Shqipëri*, Tiranë: Naim Frashëri, 1966.

Haxhi, Aleko - "Banka Kombëtare e Shqipërisë dhe politika e saj antikombëtare gjatë sundimit të Zogut", *Studime historike*, Tiranë. Mihal Duri, 1964.

Haxhi, Aleko - *Financat dhe krediti në shërbim të revolucionit dhe të ndërtimit socialist në Republikën Popullore të Shqipërisë*, Tiranë: Shtëpia botuese e Librit Politik, 1973.

Hercigonja, Dunja - *Velika Britanija i spoljnopolitički položaj Jugoslavije 1929-1933*, Beograd: Institut za Savremenu Istoriju, 1987.

*Historia e Bankës Qendrore në Shqipëri*, Tiranë: Shtypshkronja e Bankës së Shqipërisë, 2003.

*Historia e Popullit Shqiptar, vëll. II*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007.

*Historia e popullit shqiptar, vëll. III*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: TOENA, 2007.

Hoxha, Ibrahim - *Çamëria dhe Janina në vitet, 1912-1922*, Tiranë: Hasan Tahsini, 1996.

Hoxha, Ibrahim - *Turqit dhe shqiptarët*, Tiranë: Hasan Tahsini, 1994.

Hysi, Shyqyri - *Rauf Fico-Shtetar dhe diplomat i shquar*, Tiranë: Mësonjëtorja, 2007.

Iorga, Nicolae - *Histori e shkurtër e Shqipërisë dhe e popullit shqiptar*, Tiranë : Saraçi, 2004.

Iufi, Hajredin - *Çamëria nëpërmjet kronikave të kohës :1902-1940*, Tiranë: Pegi, 2007.

Iufi, Hajredin - "Politika e shtetit grek për dëbimin e popullsisë çame në vitet 1914-1928 dhe qëndresa shqiptare", *Studime historike*, Nr.1-4, Tiranë: Mihal Duri, 1997.

Jacques, Edwin - *Shqiptarët*, Tiranë: KARTË E PENDË, 1995.

Jelavich, Charles & Jelavich, Barbara - *Themelimi i shteteve kombëtare të Ballkanit :1804-1920*, Tiranë : Dituria, 2004.

- Jovanović, Jovan - *Diplomatska Istorija nove Evrope 1918-1938*, Beograd: Knjizara Koste Mihailovica, 1939.
- Kaceli, Ilirjana - "Vendosja e marrëdhënieve shqiptaro-turke gjatë viteve 1920 të shekullit të kaluar", *Studime historike*, Nr.3-4, Tiranë: Mihal Duri, 2014.
- Kaçori, Thoma - *Ndriçime*, Shkup: Shkupi, 2000.
- Këlcyra, Ali - "*Shkrime për historinë e Shqipërisë*", përgatitur nga Tanush Frashëri, Tiranë: Onufri, 2012.
- Kinross, Patrick - *Ataturku. Rilindja e një kombi*, Tiranë: Uegen, 2003.
- Kodra, Masar - *Fan Noli në rrjedhat politike të shoqërisë shqiptare : 1905-1945*, Prishtinë : Rilindja, 1989.
- Kolgjini, Tahir - *Të vërtetat shqiptaro-greke*, Tiranë, 1997.
- Konica, Faik - *Ju rrëfej grekët*, Tiranë: Ora, 2002.
- Kotini, Albert - *Çamëria denoncon*, Tiranë: Fllad, 2002.
- Kotini, Albert - *Tre gurët e zes në Prevezë, vëll.I*, Tiranë: Fllad, 2000.
- Krasniqi, Afrim - *Partitë politike në Shqipëri (1920-2006)*, Tiranë: EDLOR, 2006.
- Kulla, Ndriçim - *Dritëhije shqiptaro-greke*, Tiranë: PHOENIX, 2000.
- Kyçyku, Kopi - "Aspekte në marrëdhëniet shqiptaro-turke gjatë viteve 20-30 të shekullit tonë", *Studime historike*, Nr.2, Tiranë: Mihal Duri, 1986.
- Kyçyku, Kopi - *Mustafa Qemal Ataturku*, Tiranë: Arbri, 1993.
- Lamb, Richard - *Mussolini and the British*, London: John Murray, 1997.
- Lewis, Bernard - *Lindja e Turqisë moderne*, Tiranë: Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, 2004.
- Libardi, Camillo - *Come si e fatto re d'Albania Ahmet Zogu*, Trento: SCUOLA TIPOGRAFICA PR. ARCIVESCOVILE ARTIGIANELLI, 1940.
- Macmillan, Margaret - *Paris 1919 : gjashtë muaj që ndryshuan botën*, Tiranë: Plejad, 2006.
- Majuru, Adrian - *Bukureshti i shqiptarëve*, Tiranë: "55", 2009.
- Manda, Eleftheria - *Çamët myslimanë të Epirit (1923-2000)*, Tiranë: Toena, 2015.
- Maksuti, Kristia - *Elena Gjika dhe shqiptarët e Rumanisë*, Tetovë: Çabej, 2001.
- Margaritis, Jorgos - *Bashkëpatriotë të padëshiruar - Të dhëna mbi shkatërrimin e minoriteteve të Greqisë: hebrenjtë, çamët*, Tiranë: Bota Shqiptare, 2009.
- Melçka, Shpresa - "Mbi grabitjen e fshatarësisë së malësive të veriut nëpërmjet taksës së xhelepit (1925-1939)", *Studime historike*, Tiranë: Mihal Duri, 1988.
- Meta, Beqir - "Disa të dhëna historiografike për origjinën, popullsinë dhe vendbanimet e vllahëve", *Studime historike*, Nr.1-2, Tiranë: Mihal Duri, 2011.
- Meta, Beqir - "Kosova dhe Çamëria në gjysmën e parë të shek.XX-një vështrim krahasues", *Studime historike*, Nr.3-4, Tiranë: Mihal Duri, 2005.
- Meta, Beqir - *Politika tatimore e shtetit shqiptar 1925-1939*, Tiranë: Shkenca, 1999.
- Meta, Beqir - "Problemi i minoriteteve shqiptare dhe greke në organizmat ndërkombëtare në vitet 1925-1929" *Studime historike*, Nr 1-2, Tiranë: Mihal Duri, 2011.
- Meta, Beqir - *Tragjedia çame*, Tiranë: Sejko, 2007.
- Meta, Beqir - *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, Qendra e Studimeve Albanologjike. Instituti i Historisë, Tiranë: KRISTALINA-KH, 2013.
- Mikus, Dagobert Von - *Mustafa Qemal Ataturku, Themeluesi i Turqisë së Re*, Tiranë: Edlor, 2002.
- Milo, Paskal - *Historia e vendeve të Ballkanit 1918-1939*, Tiranë: Shtypshkronja e dispensave, 1987.
- Milo, Paskal - *Politika e jashtme e Shqipërisë, vëll.I*, Tiranë: Toena, 2013.

Milo, Paskal - *Shqipëria dhe Jugosllavia (1918-1927)*, Tiranë: Shtëpia Botuese Enciklopedike, 1992.

Ministria e Mbrojtjes Kombëtare, Drejtoria Politike, "Bullgarija e Re", Tiranë: Shtypshkronja Ushtarake, 1947.

Minniti, Fortunato - *Fino alla guerra : strategie e conflitto nella politica di potenza di Mussolini 1923-1940*, Napoli : Edizioni Scientifiche Italiana, 2000.

Mišić, Saša - "Serbo-Albanian Bank in Albania 1925-1927", *Balkanica*, issue XXXVII, Belgrade : Institute for Balkan Studies, 2007.

Misha, Kristaq - *Lëvizja punëtore në Shqipëri*, Tiranë: Naim Frashëri, 1970.

*Monarkia shqiptare (1928-1939)*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2011.

Moroco Della Roca, Roberto - *Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, Tirane: ELENA GJIKA, 1994.

Mousset, Albert - *Shqipëria përballë Europës (1912-1929)*, Tiranë: Dituria, 2004.

Musaj, Fatmira - "Veprimtaria diplomatike e Mithat Frashërit në Athinë (1923-1926)", *Studime historike*, Nr.1-2, Tiranë: Mihal Duri, 2006.

Musaj, Fatmira - *Republika Shqiptare (1925-1928)*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2018.

Nani, Umberto - *Italia e Jugosllavia 1918-1928*, Milano: LIBRERIA D'ITALIA, 1928.

Nova, Koço - *Zhvillimi i organizimit gjyqësor në Shqipëri*, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike e Juridike, Tiranë: Mihal Duri, 1982.

Osmani, Jusuf - *Vrasjet në Pragë: e Cena Beut - 1927 dhe e Alqviadh Bebit - 1928*, Prishtinë: Drini Graf-Klinë, 1997.

Parece, Gabriele - *Italia e Jugosllavia dal 1915 al 1929*, Firenze : R. Bemporad & Figlio, 1935.

Pastorelli, Pietro - *Italia e Albania 1924-1927. Origini diplomatiche del Trattato di Tirana del 22 novembre 1927*, Firenze: Poligrafico Toscano, 1967.

Psomiades, Harry J. - "The diplomacy of Theodoros Pangalos 1925-1926", *Balkan Studies*, Vol.13, Nr.1, Institute for Balkan Studies, Thessaloniki, 1972.

Puto, Arben - "Ballkani dhe Fuqitë e Mëdha", *Studime historike*, Nr.1, Tiranë: Mihal Duri, 1990.

Puto, Arben - *Demokracia e rrethuar*, Tiranë: Fan Noli, 2010.

Puto, Arben - *Historia diplomatike e çështjes shqiptare*, Tiranë: Albin, 2003.

Puto, Arben - *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha (1912-1914)*, Tiranë: Toena, 2012.

Puto, Arben - *Shqipëria politike 1912-1939*, Tiranë:TOENA, 2009.

Puto, Arben & Hysi, Vasilika - "Minoritetet në Shqipëri", Tiranë: KRISTALINA-KH, 2003.

Qirjako, Jorgji - *Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare*, Tiranë: AIIS, 2013.

Rama, Fatmira - "Problemi çam në Lidhjen e Kombeve (1923-1926)", *Studime historike*, Nr 1-2, Tiranë: Mihal Duri, 2007.

*Raport mbi gjendjen e përgjithshme shëndetësore (1912-1937)*, Tiranë: Kristo Luarasi, 1938.

Roselli, Alessandro - "Italia e Albania: Relazioni finanziarie nell ventennio fascista", *Studime historike*, Nr.2, Iljaz Fishta, Veniamin Toci, Tiranë: Mihal Duri, 1988.

Roselli, Alessandro - *Italy and Albania: Financial Relations in the Fascist Period*, London: I. B. Tauris, 2006.

Rothschild, Joseph - *Evropa Lindore Qëndrore midis dy luftërave botërore*, Tiranë: DITURIA, 2004.

- Salleo, Ferdinando - *Shqipëria, gjashtë muaj mbretëri*, Tiranë : Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, 2001.
- Saraçi, Çatin - *Zogu i Shqiptarëve*, Tiranë: 55, 2006.
- Schevill, Ferdinand - *Ballkani- historia dhe qytetërimi*, Tiranë:Uegen, 2002.
- Silajxhiç, Haris - *Shqipëria dhe SHBA në arkivat e Uashingtonit*, Tiranë: Dituria, 1999.
- Smirnova, Nina - *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit të XX*, Tiranë: IDEART, 2004.
- Stafa, Monika - *Monarkia kundër Republikës.Si u la Shën Naumi*, Tiranë: NAIMI, 2011.
- Statistikë e Përgjithshme shëndetësore për vitin 1926*, Tiranë: Shtypshkronja Tirana, 1927.
- Statistika e Përgjithshme shëndetësore për vitin 1928*, Tiranë: Shtypshkronja Dielli, 1929.
- Stevens, Robert J. - *Zhvillimet politike në Shqipëri 1920-1939*, Tiranë: GEER, 2004.
- Swire, Joseph - *Shqipëria, ngritja e një mbretërie*, Tiranë: Dituria, 2005.
- Shala, Xheladin - *Marrëdhëniet shqiptaro-serbe 1912-1918*, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1990.
- Shaw, Stanford J. & Shaw, Ezel Kural - *Historia e Perandorisë Osmane dhe e Turqisë moderne (vëll II)*, Tiranë: Jehona Study Center, 2006.
- Shkoza, Haxhi - *Financat e Shqipërisë 1839-1934*, Tiranë: Nikaj, 1935.
- Shpuza, Gazmend - *Ataturku dhe ataturkizmi në këndvështrimin shqiptar*, Tiranë: Koha, 1999.
- Shpuza, Gazmend - *Ataturku dhe shqiptarët*, Tiranë: “8 Nëntori”, 1987.
- Tajani, Filippo - *Principi di Economia Albanese*, Padova: CEDAM, 1941.
- Tase, Llukan & Myftiu, Abdurrahim - “*Bullgaria dhe studentët shqiptarë*”, Tiranë: Onufri, 2011.
- Teli, Pranvera - *Shqipëria dhe diplomacia angleze 1919-1927*, Tiranë: AIIS, 2005.
- Tocci, Terenzio - *Il re degli albanesi*, Milano: A.MONDADORI, 1938.
- Toçi, Veniamin - “Kontradiktat e fuqive imperialiste për akaparimin e vajgurit në Shqipëri pas luftes së parë botërore”, *Studime historike*, Nr.2, Tiranë: Mihal Duri, 1966.
- Toçi, Veniamin - “Projektet dhe orvatjet imperialiste për zotërimin e tregut shqiptar të monedhës dhe kreditit dhe lufta kundër tyre (1920-1924)”, *Studime historike*, Nr.2, Tiranë: 1968.
- Tomes, Jason - “The Italo-Albanian Estrangement 1933-1935 in its International Context”, në Jason Tomes, *King Zog: Self-Made Monarch of Albania*, England: Sutton Publishing Limited-Phoenix Mill, 2003.
- Traglia, Gustavo - *L’Albania di re Zog*, Roma: TIBER, 1930.
- Universiteti “Fan S.Noli”, Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë, *Lidhjet kulturore dhe historike shqiptaro-rumune*, Korçë: “PROMO PRINT”, 2012.
- Universiteti Shtetëror i Tiranës, *Konferenca e dytë e studimeve albanologjike (12-18 janar 1968)*, Tiranë: Mihal Duri, 1969.
- Ushtelenca, Ilir - *Diplomacia e mbretit Zogu i I (1912-1939)*, Tiranë: ERMIR, 1997.
- Verli, Marenglen - *Shqipëria e viteve 1912-1964 në kujtimet e Spiro Kosovës, vëll I*, Tiranë: KLEAN, 2008.
- Vickers, Miranda - *Shqiptarët, një histori moderne*, Tiranë: BOTA SHQIPTARE, 2008.
- Vinaver, Vuk - “Engleska i Italicizimi i Jugosllavije 1926-1928”, Institut Društvenih Nauka, Odeljenje za istorijske nauke. Poseban otisak iz knjige *Istorja XX veka*, Beograd, 1966.
- Vinaver, Vuk - “Anglia dhe pozita ndërkombëtare e Shqipërisë midis dy Luftërave Botërore”, në *Gjurmime albanologjike*, nr. 1, Prishtinë, 1986.
- Vllamasi, Sejfi - *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942). Kujtime dhe vlerësime historike*, përgatiti për botim Marenglen Verli, Tiranë: Neraida, 2000.

Zametica, Jovan - "Sir Austen Chamberlain and the Italo-Yugoslav Crisis over Albania February-May 1927", *Balkanica*, issue XXXVI, Belgrade: Institute for Balkan Studies, 2006.  
Zavalani, Tajar - *Histori e Shqipërisë*, Tiranë, PHOENIX, 1998.  
Zurcher, Erik J. - *Historia e Turqisë*, Tiranë: DITURIA, 2013.